



“unë jam i juaji  
dhe ju jeni t’ë  
mijt”  
martin camaj



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 144, tetor 2015**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Foto L.Shyti

## MARTIN CAMAJ ERDHI GËZOHU E LUMNOHU ROZAFAT!

Shkodrës, me ëndrra dhe prirje të vjetra dhe të reja evropiane i mungonte Martin Camaj. I mungonte poeti, romancieri, dramaturgu, folkloristi dhe albanologu që përfaqëson më se miri këtë tendencë. Shkodrës dhe Shqipërisë i mungonte shejza e prezantimit të kulturës sonë në Evropë, ...

2

## MARTIN CAMAJ DHE LETËRSIA E TIJ TJETËR

“Shkrimtari Martin Camaj ka lënë një vepër të madhe dhe me vlerë në fushën e letërsisë, gjuhësisë dhe në aspekte të tjera të çështjes shqiptare” – u tha në Koherencën “Camaj-Letërsia tjetër”. Martin Camaj është një nga shkrimtarët më produktivë të letërsisë shqipe...

3

## FJALA NË ÇEREMONINË E PËRURIMIT TË MONUMENTIT TË MARTIN CAMAJT

Kam nderin, që në këtë ceremoni, në ceremoninë e përvitshme të përvitshme të Albanologut Martin Camaj, në emër të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” t’iu përhëndoj me t’iu uroj mirëseardhjen!...

4

## Pak fjalë, pak foto, shumë kujtime

Më në fund erdhi dita e shumëpritur. Pas një pune disa vjeçare të Shoqatës “Atdhetare Dukagjini”, më datën 15.10.2015 në oborrin e bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, ngrihet madhështore shtatorja e albanologut...

6

## JU LUMTË PËR PUNËN TUAJ TË MADHE DHE MIKPRITJEN

**UKSHIN JASHARI** Kryetar i Shoqatës së Vëllazërisë “Martin Dreshaj”

Ne, delegacioni i Shoqatës së Vëllazërisë “Martin Dreshaj” i përfaqësuar nga kryetari Ukshin Jasharaj, Ali Tahiraj, Frashen e Ardit Racaj si dhe përfaqësuesit e shkolles fillore “Martin Camaj” Gurrakoc të përfaqësuar nga Mimoza Osmanaj-Kabash dhe Matem kënaqësi dhe nder të veçantë që u bëmë pjesë e marshit...

7

# MARTIN CAMAJ ERDHI GËZOHU E LUMNOHU ROZAFAT!

Shkodrës, me ëndrra dhe prirje të vjetra dhe të reja evropiane i mungonte Martin Camaj.

I mungonte poeti, romancieri, dramaturgu, folkloristi dhe albanologu që përfaqëson më se miri këtë tendencë.

Shkodrës dhe Shqipërisë i mungonte shejza e prezantimit të kulturës sonë në Evropë, i shpallur heretik atëherë kur pothuaj askush nuk shprehte interes për ne.

Martin Camaj erdhi si vezullim i një vegimi qiellor, si sovran fuqiptotë i prozës moderne në token e vet.

Kaloruar mbi Pegasin e tij magjik veshur me mantelin e artit të gjithëkohësisë Martin Camaj erdhi si jehonë e një sifonie, si muzikë e një pianoje në të cilën gjëmojnë me qindra tinguj lirikash plot shkëlqim si hëna mbi qelq.

Ulisi pas një jete mes detesh të pafund u kthye në Itakën e tij.

Gëzohu, qeshu e lumnohu Rozafat!

Hapja derën djalit tënd,

qytetarit elitar të botës që mbeti gjithnjë një Nikë Dukagjini, dhe një dallëndyshe

Shkodre.

Martin Camaj erdhi i derdhur në bronx falë mençurisë

intelektuale, përgjegjësisë qytetare dhe sfidave të guximshme të Shoqatës Atdhetare Dukagjini.

Ne sot po zbulojmë një përmendore që ADONISI i bukur i ngriti vetës nëpërmjet artit.

Ne sot zbuluam një përmendore për heretikun që iku si valë e lumit kur nata malet mbulon. Fluturoj si zog shtegtar i vetmuar me një kulaç misri ne trastë, me një laps e një fletore, por Shqipërinë e mori me vete kudo që shkoi.

Ne po zbuluam një monument për engjullin mbrojtës të gegnishtes mbretërore, që në shekullin mizor i këndoi lirisë dhe dashurisë.

Ne sot zbuluam një Apolon ku dielli i lavdisë për jetë do ta shkëlqejë e do ta bekojë sa të jetë gjallë, qoftë edhe një poet apo adhures i poezisë! Martin Camaj erdhi gëzohu e lumnohu Rozafat!

PRELE MILANI



## FALIMINDERIT PER MOS PJESËMARRJEN TUAJ

Ulisi u kthye dje ne Itakën e tij që ju be Pernazi i shpirtit?

Martin Camajn dje nuk dolën për ta pritur as një deputet i Shkodrës, as një përfaqësues i qeverisë, as kush nga rilindësit e Ministrisë së Kulturës. Martin Camaj u ndal për një pushim të pasosur përpara Bibliotekës Universitetit dhe askush nga petagogët (kësaj magazinë kartuçash, ku një pjesë e tyre shiten si kërtollat ne Rus e peshku ne Zdrale) nuk doli për ta pritur kolosin e Albanologjisë. Çuditërisht munguan edhe disa shkrimtare dhe poet Shkodëre duke mos u gjendur aty ku do ishte nderë të ishin.

Me këtë rast meritojnë një urim të veçantë: FALIMINDERIT PER MOS PJESËMARRJEN TUAJ! Pasi prezencja juaj do ta ja prishnit humorin dallëndyshe shtegtare. Martin Camaj as i gjallë as i vdekur nuk ka dashur t'ja di aq me tepër t'i adhurojë kuajt e politikës. Martin Camaj ishte fisnik rrace ndaj kurrë nuk e ndyu gojën me

sharje edhe pse ja kishin bërë vendin. Ai nuk kishte kohe të merrej me dordoleca, ndaj injorante me heshtjen e tij mospërfillëse. Martin Camaj dje u prit në mënyrën dinjitoze siç e meritonte nga njerëz të shquar të fushës së letrave nga mbare hapësira shqiptare, të cilët i benë si surprize me një Sesion shkencore organizuar nga Senatit Demokristian (me 10 kumtesa të nivelit të lartë akademik). Martin Camaj u prit në mënyrë shumë dashamirëse nga Zonja e shtëpie së Rozafës; Voltana Ademi, Kryetari i Këshillit Bashkiak Zoti Xhemal Bushati dhe Nen/Kryetari Bashkisë zoti Arben Gjuraj. Martin Camajn e priten me emocion dhe respekt intelektual, aktor te teatrit Migjeni, student, qytetare të moshave dhe kategorive të ndryshme, bashkatdhetar nga gjitha trevat tona etnike.

Marin Camaj e prit krahëhapur, sy përllotur me dashuri zemre të madhe si nëna birin e sajë më lavdishëm, ashtu siç

di presë e te vlerësojë Shoqata Atdhetare Dukagjini. Dasmarsa në këtë festë historike ishin edhe simotrat "Shoqata Malësia e Madhe Nderi Kombit", "Shoqata Martin Ndreshaj" nga Kosova dhe Mali Zi, "Shoqata Nikaj Mërturi", Klubi i shkrimtarëve Shkodër, Klubi i shkrimtarëve, Prishtinë, Klinë, Tuz etj. Martin Camaj u kthye në token e tij majën maleve me larta të kulturës shqiptare, fisnik mendjendritur, fjalëpak e punë madh si ai. Martin Camaj erdhi fluturim si yll që bie nga qelli dhe ra në token e shqipeve por edhe të breshkave e zvarranikeve. Martin Camaj erdhi e hyri në shtëpinë e vet te tronditur e plasaritur nga termetet e moteve dhe akoma është diku me afër derës, se sa kreut të vendit. Ai erdhi pa trokitur pasi nuk thirret; a doni miq pas derës se shtëpisë tënde, por për çudi as kush nuk ftoi te shkante ne qosh të munguar të oxhakut. Heratiku i vjetër, babai i letërsisë ndryshe erdhi e u ngul për të mos

u shkukur kurrë nga kjo tokë. Në toke e Martin Camaj akoma ka specie urithe që luftojnë në mënyrë të nëndheshme, akoma ka lakuriq që drita e shkëlqyer i këtij meteori u verbonte sytë, ka akoma ka ziliqarë, që quajnë, hermetik, i huaj, arkaik(gegofil) etj. Majat e larta shpesh mbulohen nga retë shtëllunguese dhe shytohen nga rrufetë gjarprusha. Ani, e çfarë mund të bëjnë retë, mjegullunajat dhe rrufetë Jezerit. Martin Camaj erdhi në token e vet, në hisen e diellit të vet, prandaj të gjithë ata që nuk e duan janë të dënuar të shohin nga poshtë madhësinë dhe vegimin e tij. Falenderimet me te përzemërta, emër për emër gjithë dukagjinave ndihmuan në realizimin shtatoreve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt. Falenderimin më të veçantë që tani e pas i përket historisë shkon për dukagjinat e Njujorkut dhe Miçigamit, në SHBA, të cilët të ndihmuan dora doras nga dhjetëra emigrant nga shtetet e

tjera evropiane dhe bujaret e vatrës së ketusdme dukagjinase i dhanë krah një ëndrrë idealiste duke e bere realitet brenda një kohe rekord. Bujaria dukagjinase edhe një herë trego se është nënëmadhja e bujarisë së shkëlqyer shqiptare. Të gjithë ata që ndihmuan me xhep (qofte edhe 500lekë), me mend dhe zemër për realizimin e këtyre dy shtatoreve nuk kanë nevojë për flete-lavdrim nga Shoqata atdhetare Dukagjini. Të gjithë ata që kanë ndihmuar për realizimin e këtyre dy shtatoreve i ka pare dhe ka falënderuar ai që nuk i shpëton as gjë pa pare gjykuar. Perëndia u shpërbleftë me shëndet, lumturi, e mirësi ne familjet tuaja. Zoti fuqiptote na e shtoftë harmoninë dhe solidaritetin për nisma tjera përjetësuese në ardhmen për personalitete të tjera rrezatuese që Dukagjini i fali kulturës kombëtare!

PRELE MILANI

# MARTIN CAMAJ DHE LETËRSIA E TIJ TJETËR

“Shkrimtari Martin Camajt ka lënë një vepër të madhe dhe me vlerë në fushën e letërsisë, gjuhësisë dhe në aspekte të tjera të çështjes shqiptare” – u tha në Koherencën “Camaj-Letërsia tjetër”

Martin Camaj është një nga shkrimtarët më përfaqësues të letërsisë shqipe. Sivjet është 90 vjetori i lindjes së tij, dhe me këtë rast në Shkodër, u organizua një konferencë me temën bosht “Camaj-Letërsia tjetër” dhe po ashtu u inauguroa shtatorja e tij

Shtatorja e punuar nga skulptori shkodran Skënder Kraja ka zënë vend para institucionit të Bibliotekës Universitare të këtij qyteti, në përrurimin e së cilës morën pjesë kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shkrimtarë dhe studiues të shumtë.

Vlen të theksohet se përrurimit të shtatores i ka paraprirë konferenca me temën “Camaj-Letërsia tjetër”, e organizuar nga Senati Demokristian dhe Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, që u mbajt Bib-

liotekën Universitare të Shkodrës.

E drejtuar nga presidenti i Senatit Demokristian, shkrimtari Lazër Stani, në këtë konferencë folën studiuesit e shkrimtarët: Arben Prendi, Xhevat Beqiri, Sadik Bejko, Ndue Ukaj, Bardhyl Londo, Primo Shllaku e Prend Buzhala.

Figura e Camajt u vlerësua nga këndvështrime të ndryshme, me çka u shpalosën vlerat artistike të veprës së tij në fushën e poezisë, prozës dhe gjuhësisë. Relatorët e vlerësuan lartë rolin e Camajt në fushën e letërsisë shqipe dhe në atë të albanologjisë.

Nga poetët e studiues që folën për veprën e tij, u kërkua që Camajt t’i jepej ai vend i merituar në hierarkinë e vlerave të letërsisë shqipe, meqë ai është shkrimtari i lartësive.

Në këtë konferencë, studiuesit u shprehën se Camaj ishte një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe dhe një intelektual i shquar i mendimit, i botës dhe i shpirtit shqiptar.

Këtë ditë kushtuar shkrimtarit të madh, e zbukuruan aktorët e Tetarit të Shkodrës që recituan pjesë nga krijimtaria e pasur artistike e Camajt.

Martin Camaj (1925-1992) është autor i shumë veprave në poezi, prozë e dramë, dhe është përfshirë pothuajse në të gjitha antologjitë ku flitet për shkrimtarët shqiptarë. Camaj njihet si njëri ndër albanologët më të shquar, kryesisht me punimet mbi gjuhën shqipe dhe historinë e saj.

Korrespondenti i Gazetës “Dukagjini”



## FJALA PERSHENDETESE E N/KRYETARIT TE SHOQATES “ATDHETARE-DUKAGJINI” GJERGJ LEQEJZA

Të nderuem pjesëmarrës,

Asht një nder e privilegj i veçante për mue te jem prezent, e aq ma tepër te përshëndes ne një aktivitet te tille ne prani te personaliteteve te shqueme ne fusha te ndryshme te kulturës e arsimit.

Te flasish për një personalitet si Martin Camaj, qe për mendimin tem i kalon kufijtë Kombëtare Shqiptare ... për nga përmasat e kontributi ne letërsi, albanologji e te tjera, e sidomos para një auditori profesional e i nderuem si ju asht një përgjegjësi e njëkosisht nder i madh.

Ky takim i një niveli te nalte përfaqësimi e profesionalizmi i paraprin inaugurimit te vendosjes se statujës se te madhit Camaj ne sheshin para ksaj biblioteke qe do te realizojmë s’bashkut mbas pak kohet.

Realizimi i ktij projektit vjen si finale e një procesi te gjate e aspak te lehte qe Shoqata Atdhetare “Dukagjini” e mbeshtetun nga bashkësia i lidhur gjeografikisht e shpirtnisht me kte krahine si dhe nga ambienti akademik shkencor ka zhvillue pa rreshte për shume vjet, me qëllimin e objektivin për evidentimin, publikimin, vlerësimin e nderimin e vlerave patriotike, shpirtnore e kulturore te zonës e përfaqësuesve te saj, ne maje te te cilëve pa dyshim qëndron i madhi Martin Camaj....

Postmortem në Shqipëri janë ba përpjekje jo të pakta për ta ba të njoftun e për të vlerësue Martin Camajn dhe ve-

prën e tij. Më 1996-n, Ardian Klosi botoi një pjesë të madhe të veprës letrare të Camajt; në fillim të viteve ’90, botuesi “Camaj-Pipa” në Shkodër botoi gjithashtu një pjesë të veprës letrare Camajan. Më

Camaj, asht kthye monument Kulture, se cilës i asht vu dhe pllaka përkatëse. Më 2002-shin, Martin Camajt i’u akordua çmimi kombëtar për letërsi “Penda e Artë”. Për veprën letrare Camajn janë

në vetëdijen kolektiv e shqiptare dhe trajtohet ma shume si shkrimtar e studjues i mergatase me shume se i joni... e ne kte kuadër Shoqata jone ka marre nismen e randsishme per te ndikua ne evidentimin e perjetesimin e figurave te shquara si Martin Camaj ...

Por kjo nuk mund te realizohej pa ndihmën e çmueme e bashkëpunimin e personaliteteve kryesore te pushteteve vendore e qendrore, te cilët gjej rastin ti përshëndesë e falënderoj për zemërsisht ... faleminderes këshillit Bashkiak e drejtuesit te tij për bashkëpunimin, faleminderes ne mënyrë te veçante kryetarit te bashkisë Shkodër te asaj kohe për kontributin e veçante jo vetëm ne kte rast ... Falënderojmë “Senatin Demokristian” për idenë e organizimin te ksaj konference

Një falënderim shkon edhe për bibliotekën Austriake e sidomos drejtuesen për predispozicionin e bashkëpunimin e vazhdueshëm ne realizimin me sukses te aktiviteteve te nivelit te tille dhe ne fund jo për nga randsija, një falënderim për te gjithë ju, qe keni marre mundimin e barrën për te kenë prezent e ligjërue ne kte konference shkencore, te cilës i uroj me zemër sukses...

Faleminderes për vëmendjen dhe sukses!



2010-n, shtëpia botuese “Onufri” botoi veprën e plotë letrare të Camajt. Poezi të ti gjenden në disa antologji. Po ashtu, më 2010-n, ish-presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, e nderoi Camajn me titullin “Nder i Kombit”. Po, ne kte vit nga Këshilli i Bashkisë se qytetit Shkodër, i dha titullin “Qytetar Nderi te qytetit Shkodër”. Gjithashtu, me urdhnin e Ministrisë se kulturës, shtëpia e lindjes se Martin

shkruar libra (Anton N. Berisha, Koçi Pe-triti, Ymer Çiraku, Primo Shllaku, Behar Gjoka), punime master dhe disertacione. Vjetë, ne fundit dolën libra seriozë studimorë nga Hasan Sinani (2011) dhe Albana Alia (2014). Më 2013-n u xhirua dhe u shfaq dokumentari biografik i gazetares Tefta Radi “Martin Camaj i paperseritsh-em”, po prapëseprapë, duket sikur Martin Camaj ende nuk e ka vendin e duhun

# FJALA NË CEREMONINË E PËRURIMIT TË MONUMENTIT TË MARTIN CAMAJT

Të nderuar miq!

Të nderuar autoritete vendore të Qarkut Shkodër!

Të nderuar pasardhës të albanologut Martin Camaj!

Zonja e zotërinj!

Kam nderin, që në këtë ceremoni, në ceremoninë e përrimit të monumentit të Albanologut Martin Camaj, në emër të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" t'iu përshëndes dhe t'iu uroj mirëseardhjen!

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në vjeshtën e vitit 2013, mori vendimin, që të bëhen përpjekjet e mundshme për të ngritur dy monumente dhe për t'iu vendosur në qytetin e Teutës, në qytetin e Fishtës, në qytetin e Luigj Gurakuqit të dy figurave gjithëpërfshirëse të bashkësisë dukagjinase, me të cilat krenohen jo vetëm dukagjinast me to, por krenohet shkodrani me to, krenohet e gjithë shqiptaria me to. I pari ishte për atdhetari Mehmet Shpendi, në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së Tij. Dhe i dyti ishte albanologu Martin Camaj, në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së tij, i cili është i shquar si shkrimtar, si poet, si gjuhëtar dhe albanolog i madh në jetën e tij 67 vjeçare.

Vërtetë ishte një ëndërr, që vetëm idealistët mund ta bënin realitet këtë ëndërr. Dhe ja, në saj të mbështetjes ligjore të Kryetarit të Bashkisë së qytetit, Lorenç Luka dhe i mbështetur nga Këshilli i këtij qytetit, i miratua propozimi ynë ... Kur na u kthye përgjigja, nga Kryetari i Bashkisë, që në mes të tjerave shkruhej ... " ... Ju bëjmë me dije se Bashkia Shkodër shprehet ... dakord, që këto dy figura të shquara të jene

pjesë e dekorit historik të qytetit të Shkodrës ...", sikur u bëmë me krahë shqiponje që të fluturonim ...

Filluam menjëherë punën që të bënim të njohur ketë nisëm dhe ketë miratim nga strukturat kompetente. E shpërndamë në Nju-Jork nëpërmjet kolegut tim, N/kolonel Mark Dreni në pension; në Miçigan nëpërmjet biznesmenit në Miçigan, Ndue Ftoni e Kryetarit të Shoqatës "Dukagjini" në Miçigan, Nikolin Shyti; Leke Gila në Belgjike, Kole Çardaku, Gjon Dukgilaj, Prenda Mark Shpendi e Martin Martinaj në Shkodër, të cilët u benë nismëtarët e bashkimit të dukagjinastve kudo janë vendosur për të ngritur çerdhen e tyre të jetës. Bashkësia dukagjinase mblodhi 82 % e gjithë fondit përkatës, që u dallua në mënyrë të veçante bashkësia e dukagjinase në Nju-Jork, e cila mblodhi 58 % të tij. Janë gjithsej 183 kontribuues, pa të cilët nuk mund të mendohej për tu ngritur këto dy monumente. Ata, sigurisht i falënderon dhe ju është shume mirënjohës Shoqata, por edhe ju pjesëmarrës në këtë ceremoni ju jeni shume mirënjohës. I urojme me urimin popullor "Paçin e dhënçin!"

Me datën 16 korrik 2015, përuam monumentin e atdhetarit Mehmet Shpendi, i cili u dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani, me urdhrin "Nderi i Kombit". Sot, përrurohet monumenti i albanologut të shquar Martin Camaj-Nderi i Kombit.

Unë, nuk do të flas për jetën e veprën e albanologut të shquar Martin Camaj-Nderi i Kom-

bit, sepse u fol në Konferencën Shkencore e organizuar nga Senati Demokristian, por desha që përpara jush të publikoj pak punën e Shoqatës, që është bere për t'ia arritur kësaj dite.

Ja si e përjeton ketë moment, poeti, shkrimtari dhe publicisti ynë, Prele Milani: "Shkodrës, me ëndrra dhe prirje të vjetra dhe të reja evropiane i mungonte Martin Camaj. I mungonte poeti, romancier, dramaturgu, folkloristi dhe albanologu. Gëzohu, qeshu e lumnohu Rozafat! Hapja derën djalit tënd, qytetarit elitë të botës që mbeti gjithnjë një dallëndyshe Shkodre. Martin Camaj po vjen i derdhur në bronz falë mençurisë intelektuale, përgjegjësisë qytetare dhe sfidave të guximshme të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini". Ne sot zbulojmë një përmendore për heretikon që iku si valë e lumit kur nata malet mbulon. Ai iku me një kulaç misri në trastë, me një laps dhe me vete mori Shqipërinë kudo që shkoi. Ne sot po zbulojmë një monument për engjëllin mbrojtës të gegnishtes mbretërore, që në shekullin mizor i këndoi lirisë dhe dashurisë. Ne sot po zbulojmë një përmendore, ku dielli i lavdisë për jetë do ta shkëlqejë e do ta bekojë sa të jetë gjallë, qoftë edhe një poet dhe adhures i poezisë". Vështirë të gjenden shprehje më të goditura për ketë moment. Ju faleminderit zotit Prele Milani.

Ajo që ka rendësi nuk është shume pushtimi i një pike në hapësirë, ose i një njohje shkencore, sa krijimi i një klime të morale. Dhe ne, besojmë, se me punën që ka bere shoqata nëpër-

mjet veprimtarive të saj në këto 12-13 vjet, por në veçanti me këto dy monumente kemi krijuar një klime tjetër morale për dukagjinast kudo që janë duke e ndjere veten krenar për kontributin e të pareve të tyre në çështjen shqiptare si dhe për atë që po japin ata në bashkësitë kudo që kane ndërtuar jetën e tyre. Ketë e vërteton dhe pjesëmarrja e juaj, që ju jemi shume mirënjohës për mbështetjen që na keni dhënë dhe na jepni.

Në këtë përrurim kemi miq nga Shoqata "Martin Dreshaj" në Kosove; nga Rrezhaja, nga Shoqata "Dede Gjon Luli", në Tuz; Mjeshterin Shtjefen Ivezaj, një nga etnografet që përfaqëson mbare shqiptarinë; nga Shoqata "Nikaj-Merturi"; nga Shoqata "Mirdita"; nga Shoqata "Malësia e Madhe-Nderi i Kombit"; nga Shoqata kulturore "Spani"; nga Ansambli "Treva Dukagjini"; Shoqata e Shkrimtareve Shkodër dhe në Malësi të Madhe; miq nga Librazhdi; nga drejtorja e Monumenteve të Kulturës; nga Shkolla 9 vjeçare "Martin Camaj", të komunës Istog dhe të bashkisë Shkodër; nga Instituti i studimeve Albanologjike të Universitetit Muni; nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër; Pushteti vendor të Qarkut Shkodër; përfaqësues së bashkisë dukagjinase në Nju-Jork; banore të qytetit Shkodër e të tjerë e të tjerë. E gjithë kjo pjesëmarrje jo vetëm që na miraton punën e bere deri tani, jo vetëm na nderon, por është dhe një mbështetje e madhe për të ecur pa u ndalur në realizimin e plote të misionit të Shoqatës. Me lejoni q Në këtë përrurim kemi

miq nga Shoqata "Martin Dreshaj" në Kosove; nga Rrezhaja, nga Shoqata "Dede Gjon Luli", në Tuz; Mjeshterin Shtjefen Ivezaj, një nga etnografet që përfaqëson mbare shqiptarinë; nga Shoqata "Nikaj-Merturi"; nga Shoqata "Mirdita"; nga Shoqata "Malësia e Madhe-Nderi i Kombit"; nga Shoqata kulturore "Spani"; nga Ansambli "Treva Dukagjini"; Shoqata e Shkrimtareve Shkodër dhe në Malësi të Madhe; miq nga Librazhdi; nga drejtorja e Monumenteve të Kulturës; nga Shkolla 9 vjeçare "Martin Camaj", të komunës Istog dhe të bashkisë Shkodër; nga Instituti i studimeve Albanologjike të Universitetit Muni; nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër; Pushteti vendor të Qarkut Shkodër; përfaqësues së bashkisë dukagjinase në Nju-Jork; banore të qytetit Shkodër e të tjerë e të tjerë. E gjithë kjo pjesëmarrje jo vetëm që na miraton punën e bere deri tani, jo vetëm na nderon, por është dhe një mbështetje e madhe për të ecur pa u ndalur në realizimin e plote të misionit të Shoqatës, të cilëve ju jemi shume mirënjohës!

Me lejoni, që përulësisht t'ju falënderoj me gjithë zemër, në emër të Shoqatës dhe t'ju shpreh mirënjohjen më të thelle për mbështetjen që na jepni!

Me lejoni që në emrin tuaj, të përshëndes dhe punën krijuese të mjeshtrit, Skulptorit Skënder Kraja, që së bashku me vajzën e tij, Beskida, bashkautor, punuan me kaq mjeshtëri në punimin e këtij monumenti. Ju lumtë!

Ju faleminderit!

**NDUE SANAJ**

## FJALA NË DREKEN ME RASTIN E PËRURIMIT TË MONUMENTIT TË MARTIN CAMAJT

Të nderuar miq!

Zonja e zotërinj!

E ndjeje veten shume të emocionuar, që në këtë trevës me ne, jeni ju miq të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe të Dukagjinit, përfaqësues të Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani; përfaqësues të Qeverisë; autoritete vendore të Qarkut Shkodër; miq nga Kosova, shqiptare në Mal të Zi, kolege nga Mirdita, nga Nikaj-Merturi, nga Malësia e Madhe; nga Librazhdi; përfaqësues të pasardhësve të Martin Camaj, e të tjerë e të tjerë. Të gjithëve ju uroj mirëseardhjen, me shprehjen popullore "Mire se ju ka pru Zoti!"

Ma shton krenarinë, se ne, banoret e rij dukagjinast në qytetin e Shkodrës, që i përfaqëson Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" arriti jo vetëm të paraqes deri tani një histori të gjere dhe shkencore të tyre, por dhe të kenë në piedestalin e pavdekësisë dy figurat më përfaqësuese të tyre, të vendosura në ketë qytet. Por, më lejoni të theksoj, ne "ardhacakët", nuk jemi endacake, por njerëz që kemi ardhur në qytetin e Shkodrës dhe jemi bere banore të rinj të tij, njerëz që dimë të mbijetojmë kudo, njerëz që dimë të kapin shpejt të rene, njerëz që dimë të bëjmë historinë dhe atë ta prezantojmë kudo me krenari, njerëz

që dimë të japim atë që duhet dhënë për të mirën e shqiptarisë. Nuk jemi ne, që dogjëm e premë në Shkodër; nuk jemi ne që përdhunam Shkodrën; nuk jemi ne që vodhëm Shkodrën; nuk jemi ne që thyem, vodhëm e dogjëm bankën e shtetit; nuk jemi ne që detyruam qytetaret e Shkodrës të organizojnë ruajtjen e shtëpive, të pallateve, të rrugicave apo të dyqaneve; nuk jemi ne që qytetin e Shkodrës e kthyem në një fshat të Madh të prapambetur!!!

Ju themi atyre që kane këto mendime raciste për banoret e rinj të qytetit Shkodër, qofte malësore, qofte dukagjinast apo qofte fusharake: Ne, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", përfaqësuese e dukagjinastve kudo që janë, dimë të mbajmë një gazete pa u ndalur tash 13 vjet, fale kontributit vullnetar të anëtarëve të redaksisë së saj dhe financuesit dukagjinast, në veçanti Ndue Ftoni dhe Gjergj Leqezja, që dimë të organizojmë e

të drejtojmë 8 simpoziume shkencore, që dimë dhe të studiojmë e botojmë, dhe tash në fund që dimë të ngremë në qytetin tone, atdhetarin Mehmet Shpendi dhe e sjellim në te, pas 100 vjetëve të rënies së tij, të jete i përjetshëm, që dimë të sjellim albanologun Martin Camaj në vendin e vet e të prehet përjetësisht në monument prej bronzi.

Disa njerëz të mëdhenj, nga një here nuk e di se çfarë i bën të mos shikojnë, se çfarë behet rreth tyre dhe shkruajnë aq me zymtësi për shkoderanet e rinj?!

Me falni për ketë pak prishje të këtij gëzimi ..., Por, isha i detyruar të theksoja kaq, në ketë moment, në ketë arritje të tonën, së bashku me ju, duke pire nga një gote gëzimi për veprën e pavdekshme të albanologut Martin Camaj.

Edhe një here mire se keni ardhur!

Shëndeti i gjithëve juve miq!  
Shëndeti i gjithë anëtarëve

të kryesisë, aktivistëve dhe anëtarëve të shoqatës!

Shëndeti i gjithë kontribuuesve, që na mundësuan për realizimin e këtyre dy veprave madhështore!

Shëndeti për Senatin Demokristian, dhe të lektoreve, që mundësuan përgatitjen dhe zhvillimin e këtij sesioni shkencore, në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së Martin Camaj!

Shëndetin e fundit, e kam për gjithë autoritet vendore, që dolën nga zgjedhjet e 21 qershorit të këtij viti. Ta gëzojnë detyrën! Por, në mënyrë të veçante e kam për zonjën Voltana Ademi, kryetare të Bashkisë Shkodër, dhe në emrin tuaj, ti uroj me faqe të bardhe dhe me këmbë të lehta ketë detyre kaq të vështirë, kaq të rëndësishme, kaq fisnike e qytetare!

Lavdi veprës së albanologut Martin Camaj-Nderi i Kombit!

Gëzuar rrethas!

Ju faleminderit!

**NDUE SANAJ**

# Tema e vetmisë dhe e vdekjes në poezinë e Martin Camajt

SADIK BEJKO

Gjithmonë kam menduar se në fillim ndodh pranimi logjik i një shkrimtari. Në leximin e parë ai troket fort, pastaj e lexojmë prapë dhe shkallë-shkallë ai hyn tek ne, zë vend në njohjen tonë si artist me rëndësi. Në rastin e Camajt njohja tek ne erdhi me vonesë dhe si e flakur midis nesh, si e hedhur midis sheshit, prej gazetave, prej politikës, të cilat sikur të thoshin: ja, shiheni çfarë poeti, çfarë poezie...! Ju që vini nga shkollimi komunist, nga realizmi socialist, nuk e kapni dot artin e Camajt. Por, pavarësisht këtyre, që me leximet e para pas vitit 1990 arti i Martin Camajt u mirëprit.

Por pranimi logjik nuk mjafton. Mund ta pranosh një autor dhe, pas një leximi, e hedh atë në një kënd, nuk komunikohet më me të.

Pranimi i vërtetë vjen me kohë, do kohën e vet, vjen atëherë kur një autor e kemi përvetësuar edhe emocionalisht. Mund t'i mbajmë a mos t'i mbajmë përmendësh vargjet, por jemi mbushur plot me përfytyrimet e poezisë së tij, me ndjeshmëritë që burojnë prej shtresimeve të tekstit të tij; tani këto pasuri janë tonat; kur të na "duhen", u kthehem, na vijnë vetiu ndër mend, ose marrim librin dhe i rizbulojmë.

Libri i parë që kam nga Camaj është "Gedichte", (Poezi), një përmbledhje me 44 poezi dhe 7 proza poetike me përkthim në gjermanisht, botuar në Mychen, 1991. Shtatë prozat poetike të këtij libri janë marrë me po atë renditje nga libri "Njeriu më vete e me të tjerë", 1981.

Duhen thënë dy fjalë për këtë libër. Është një përzgjedhje bërë me dijeni të autorit në fund të jetës së tij.

Toni mbizotërues i këtij libri është trishtimi. Aty gjejmë Martin Camajn intim, të mërguar, "Larg nga ata që flasin si unë" dhe njëherësh të rikthyer me mjetet e poezisë në vendlindjen e munguar. Dy temat kryesore të këtij libri, ajo e vetmisë dhe e vdekjes janë vënë në sfondin e Dukagjinit, në erën mitike të Veriut, të Veriut si klimë, si simbolikë, si sfond malesh, si vend i durimit stoik, si qëndresë në mungesat më elementare jetike dhe si tërheqje urtake në vete. Ky mërgim prej mërgimit, a shtegtim prej mërgimit, kjo vendosje në mal, në primitivitet, është e sajuar artistikisht, e ëndërruar, e ndërnuar si ngrehinë virtuale, si ajër për t'u mbrojtur e për t'u arratisur nga shpërbërja.

Autori thellë-thellë të jep përshtypjen se është nisur në udhën që të çon larg nga bota e të gjallëve. Si tek njeriu në jerm, njeriu me frymëmarrjen e rënduar të fundjetës, kjo poezi flet me të vdekurit, me atin, me nënën, të cilët nuk janë më (kur është botuar ky libër), pastaj kujton të vëllanë... lë dhe amanetet e fundit. "Larg atyre që flasin si unë", nga Lulja, e dashura, kërkon një "shtyllë guri" ku të mbahet larg nga vdekja që lajmërohet që në vargun e parë të kësaj poezie.

Tazes, gruas, i lë një amanet: meqë ai do të vdesë "mes njerzve gjithmonë të nginjun",... "ndër drekët e mija qitni vetëm kafe të idhta". Kjo kontraston me drekët për vdekjen e atit ku "... prenë dy qe /me ngimun të unshmit e thneglat e lamit/ me grimca buke"

Te "Moshë e qenit ose ditëlindja" festa kthehet në drekë, edhe pse "kremtuen gjithnatën i ri e i vjetër". Në mëngjesin që vjen, qentë nuk presin mbas dere si

ushqim eshtrat e mbetura nga festa, por atë njeriun... kremtuesin e ditëlindjes.

Ka kaq trishtim në këtë poezi për ditëlindjen, sa nuk ia gjen shoqen në gjithë letrat shqipe.

Trishtimi, zvjerdhja, shënohen që në titullin e poezisë: moshë e qenit... Sipas mendësive fshatare, me ngrysjen e moteve, kur të lënë forcat, dhe, për pasojë, shtohen qarjet nga jeta, ke hyrë në moshën e qenit.

"Kremtuen... kohën që vdiq e vrame në mue"... "E thanë: askush s'do të lyp gjak për të". Lypet gjak për kohën? Mos ka ndonjë gjak të pamarrë M. Camajt?

Atëherë, pse përmendet gjaku që nuk mund të merret? Pse festa kthehet në drekë mortore?

Askush nuk i lyp gjak fatit të keq.

Camaj e ka paramenduar: ata që e vuajtën luftën e ftohtë do të shkojnë gjakhupës. Nuk do të ketë as të penduar, as përgjegjës për ata që vuajtën nën "murlanin e kuq", siç e cilëson komunizmin te poezia "Dy brezni".

Te poezia "Ime amë" flet shqemëza që dridhet e thatë në shkamb, mbi Dri, e rrahun nga fryma e tërbueme në Shëndre: "je barrë e vrame/ në parzmin tim!/ Kaloje lumin para sosjes/ të dimnit".

Nëna e autorit ka vdekur. Si në një halucinacion te shkëmbi mbi Dri është nëna e shndërruar në një shqemëz. Je pjellë e fatit të keq. Eja, kapërceje fatin e keq. Barrë e vrame. Autori, arti i tij, mbetën të përjashtuar, të akulluar në dimër. Vetëm vdekja do t'i çmagjepsë largësitë, do t'ia fashisë e t'ia paqëtojë makthet, do ta pjekë me nënën, me mjediset e me këdo tjetër nga të tjtë.

Në Tingujt e parë, poezi që hap librin, i ati i thotë të birit "Mos u tremb" ndërsa dëgjohej shunullimat ngjethëse të ortiqeve.

Kjo poezi shënon mjedisin e zanafillës së heroit lirik të librit, sfondin e krejt librit: ujq me veshët çyrek përpjetë, ortiqe, qiell me re, lumenj të turbullt me gur e lëndë, njerëz në shtigjet e ngushta të malit, njerëz në uri dhe etje.

Në poezinë Dy brezni, i ati portretizohet si burrë fort i ashpër me bijtë, me fjalën si "ulurimë ujku t'unshëm/ ndër karma, vetëm". Megjithatë gdhendet dhe si burrë i frytshëm, "... pamje trishtë/ dru ullini pa fletë/ me kokrra të zeza në çdo degë".

I vëllai i Martinit, malsori kambë-zdathë i diktaturës shqiptare, kur "i fryn zjarrmit...", të gjitha shkëndijat i bahen/ djelm". Ai gati e ka zili vëllanë e vet kambë-zdathë, ngaqë vetë nuk pati fëmijë. E, pra, për të, për një baba pa djalë, askush nuk do të marrë gjak.

"Personazhet" e tjerë të librit janë dallëndyshja, korbi, dreri, gjarpri. Më tepër simbole...

Edhe hijet, syrrerit, gruaja në mëngji, jugorja në Veri, janë njerëz në vetmi, të kapur pisk në rrethana tragjike.

"Hija e lisit" vjen si poezi e një niveli të lartë të shkrimit. Kjo poezi sikur mbyllet, nuk lë çelësa jashtë, as shtigje të fshehura për t'i hapur. Eshtrat e të vdekurit si gur, hija e lisit gjithësuadues si mëndafshi i hollë e i zi në faltore, hija që zgjatet nga mali në mal, nga agu në muzg, hija në shkëmbin e malit si gjarpër nëpër rremb.

Imazhi më i bukur i poezisë, mbase i gjithë librit është ky: "Gjingallat mbi dega gjimojnë/ njiheri në vapë sikur vajtoje/ me fytyra t'gërvishtuna n'gjamë".

Një tempull i përzishëm, me njerëzit si cokla, pa jetë. Me gjamën e gjinkallave, me gjarpurin në rremb, me zi, ligësi dhe frikë. Tabllo e totalitarizmave të shekullit njëzet, totalitarizma që pol-

lën njerëz kufoma..., kampe të vdekjes...

Poezia "Drekë malsore" ka një monumentalitet tragjik. Shkrimi i përmbahet parimit që Camaj shpreh te poezia "Trajta": 'Pendël e lehtë në dukje/ por e randë hekur në peshë/ tingull ose ngjyrë/ e kthjellët deri në dritë'.

Përsëritet tri herë vargu: "Sot është marrë një gjak". Tema është dreka malësore e mortit.

Në malësi jeta dhe vdekja i takojnë bashkësisë. Dreka, përcjellja e të vdekurit si situatë, e merr të gjithë rëndesën. Vajtimi bëhet kolektivisht: gjama e burrave... Ushqimi për të gjithë shtrohet e ahahet kolektivisht. Dreka e mortit si zakon pajton bashkësinë, sjell harmoni. I vdekuri mbyllet shpejt në tokë. Jeta e bashkësisë me drekën e mortit nis nga e para. Ky fillim e do një fli: gjakun e kaut. Paqja shtrihet në harmoninë e elementeve të mjedisit, tokë e qiell. Nata vjen me tokë të re, hanë të re. Me këtë pajtim njerëzor e gati kozmik edhe ujqit urtësohen lëpijnë nga gjaku i flisë mortore.

"Dreka malësore" sjell cilësi e mendim poetik të shënuar. Një nga kryeveprat e autorit. Duke iu përmbajtur tonit tronditës, me ngjyrim mortor, lënies së amanteve si tema kryesore e librit, po veçoj poezinë Mes Shëngjergjave, "Nëpër palcin e eshtrave/ ndiej frymën e vdekjes." Ajri digjet... më dhambin vetëm s'yt/ do të shohin dhambët e amshimit/ tue u mbyllë përpara". Me këto tri vargje M. Camaj na thotë se poezia, krijimtaria e tij do t'i dorëzohen amshimit. Ai ka qenë i ndërgjegjshëm për peshën e artit të vet. Tej çdo modestie, te proza poetike "Gjarpijtë" ai thotë që: "... Zemra m'a ndien se nuk do të jem një zog që rrah flatrat vetëm një verë". Poezia e M Camajt është në fondin me të shëndoshë të poezisë sonë.

## Martin Camaj shkrimtari i vendit të shqiponjave!

- Përhëndetje e sekretarit të Shoqatës "Martin Dreshaj" -

FRASHER RACAJ

I nderuari kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj!

Të nderuar dukagjinat dhe pjesëmarrës të këtij përvjetori madhështor!

Ta përkujtohet sot, Martin Camaj do të thotë ta përjetosh një botë dhembje dhe përkujtimi për sa e sa intelektual e vepërimitar të ndritur të kombit tonë që katrahurat jetësore i detyruan ti marrin rrugët e botës, këtu kujtojmë sa e sa mendje të ndritura të kombit tonë që u detyruan të jetojnë në mërgim nga

kushtet e renda nga presionet e pushtuesve apo nga regjimet e sistemeve të ndryshme që kaloi vendi ynë, kujtojmë vëllezërit Frashëri, Pashko Vasen, Çajupin, Ndre Mjeden, Atë Gjergj Fishtë, Fan Nolin, Faik Konicën e shumë e shumë intelektuale krijues që me penën e tyre ndriçuan rrugën tonë të zhvillimit dhe të qytetërimit. Kujtojmë sot nëntëdhjetë vjetorin e lindjes së poetit, prozatorit dhe romancierit të mirënjohur, Martin Camaj i cili përvjetor e gjene Dukagjinit dhe mbarë kombin tonë në kthesën e madhe histo-

rike të vlerës dhe nderimit për atdhetarin Martin Camaj, por edhe për atdhetaret tjerë që çdo herë kane kontribuar për kulturën, civilizimin dhe gatuan qytetërimin shqiptar.

Martin Camaj, i cili kaloi fëmijërinë në Malësinë e Dukagjinit dhe Pleqërinë në Malësinë e Gjermanisë së jugut, mbarti me vete dy dëshira që ceremoninë mortore ta bëjë në të njëjtën kohë në Dukagjin me Dukagjinat më zakonet autoktone që pasqyrojnë shpirtin dhe rrugën e vështirë të malësorit dukagjinas për mbijetesë dhe një ceremoni mortore në mërgim në mesë njerëzve të ngjishëm gjithmonë si i quante poeti në poezinë "Elegji e Parë", ku i drejtohet Tazes: Mos të vije keq ty Taze, për mue të shtrimë mbi drrasat e vdekjes, kingj i gatun

për flije, leni plakat të qajnë mbi mue atë ditë për njerëzit e vet, vdekë qysh kur. Që do të thotë vdekur qysh atë ditë që ka marr rrugën e mërgimit. Poeti më një ndjeshmëri të madhe i drejtohet edhe gruas dhe përkujton babin, qe kur i vdiq i prenë dy qe më i ngi të unshmit, poeti vdesë mes njerëzve të ngjishëm, prandaj e porositi gruan që për drekë të qet vetëm kafe të idhta. Dukagjini i thotë sot Martin Camaj se, Dukagjini dhe Atdheut i hapësirave të tij që do të bëhet Shqipëri e Bashkuar përkujton vetëm datëlindje të Martin Camaj dhe të Atdhetareve që aç shumë i dhanë këtij Kombi, duke i ngritur në pedestalin më të lartë të përjetësisë.

Martin Camaj më krijimtarinë e tij, më veprën e tij, më kohën e vranë që kaloi në mërgim na la

frymëzimin dhe atdhedashurinë që kurrë më të mos përsëritet të personalitetet e njohura të kombit tonë rruga e të jetuarit larg Atdheut, fat që e kishin dhe e kanë akoma sot shumë atdhetar.

Në emër të Shoqatës së Vëllezërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë dhe të anëtarësisë së gjerë që nga Kosova Lindore, Rozhaja, Plava e Gucia e deri në Malësi të Madhe të Mbi Shkodrës, e urojmë Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", për punën kolosale që bëri për realizimin e dy projekteve të mëdha, ngritjen e shtatorës së Dëshmorit të Kombit Mehmet Shpendi në korrik të këtij viti dhe tash më realizimin dhe ngritjen e shtatorës së liberatorit Martin Camaj!

Marrë nga gazeta "DRITA"

# Pak fjalë, pak foto, shumë kujtime

- Reportazh -

Më në fund erdhi dita e shumëpritur. Pas një pune disa vjeçare të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", më datën 15.10.2015 në oborrin e bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, ngrihet madhështore shtatorja e albanologut dhe poetit Martin Camaj. Grupi i punës i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", që për vite me rradhë ka punuar për të vlerësuar me atë që i takon figurën e këtij kollosi të letrave shqipe, sot ka të drejtë të festojë. Falendërimet për të gjithë ata dukagjinas që përkrahën dhe mbështetën iniciativën tonë për të realizuar shtatorët e luftëtarit Mehmet Shpendi dhe albanologut Martin Camaj. Mirënjohje të veçantë për bashkëatdhetarët tanë nga Neë York dhe Michigan në SHBA, Blegjika, Zvicra, Italia, por edhe të gjithë ata që kontribuan sado pak. Kjo ditë e shënuar, që me plot gojë mund të quhet rilindja e poetit Martin Camaj, ishte perceptuar si një aktivitet i larmishëm, që do të fillonte me konferencën shkencore organizuar nga "Senati Demokratik i Shqipërisë" dhe Shoqata "Atdhetare Dukagjini" në ambjentet e bibliotekës së Universitetit.

Konferenca shkencore, me temë "Camaj-letërsia tjetër", kishte sjellë në qytetin e kulturës historianë, poetë dhe studiues nga të gjitha trojet shqiptare. Aty, me mjaft vlera dhe interesim nga të pranishmit, praqitën kumtesat e tyre z.Arben Prendi, Xhevdet Beqiri, Sadik Bejko, Bardhyl Londo, Ndue Uka, Primo Shllaku dhe Prend Buxhala. Secili prej tyre solli përshtypjet, këndvështrimin dhe vlerësimin e tij për veprën e Camajt. Me mjaft interes dhe emocion për të pranishmit u përcollën pjesë nga krijimtaria e Camajt. Nën interpretimin e aktrëve të teartrit "Migjeni" Merita Smaja dhe Gjon Kola, të dukej sikur mesazhi poetik dhe aristik i autorit është aktual dhe i domosdoshëm edhe në ditët e sotme.

Në një sallë të mbushur plot me miq dhe të ftuar. Përfaqësues nga shoqata Kosovë-Malesi e Madhe "Martin Ndreshaj", nga shoqata "Nikaj Mërturi", shoqata "Malësia e Madhe Nderi i Kombit", "Klubi i Shkrimtarëve Shkodër", shkrimtarë dhe pedagogë nga Prishtina, Klina, Tuzi, përfaqësues nga presidenca, nga konsullata austriake me qendër në Shkodër, "Senati Demokratik i Shqipërisë" dhe Arqipeshkvia Shkodër-Pult.

Pjesëmarrja e pedagogëve dhe studiuesve nga qyteti i Shkodrës la për të dëshiruar, por ndoshta përballë madhësisë së Camajt vërtetë do të dukeshin si breshka, mbase kjo ishte arsyeja përse preferuan ta bojkotonin. Ja vlen të falendërojmë zonjën e parë të qytetit Voltana Ademi, kryetarin e këshillit bashkiak



z.Xhemal Bushati, nënkryetarin e bashkisë z.Arben Gjuraj, që me praninë e tyre vlerësuan, respektuan dhe përcollën këtë aktivitet, i cili për nga përmasat dhe organizimi ishte në nivele mjaft të mira.

Sapo dolëm nga konferenca shkencore në oborrin e bibliotekës, aty ku tani e tutje do të ngrihet madhështore shtatorja e Martin Camajt, gjetëm dhjetra qytetarë që po na prisnin. Ceremonia e zbulimit të kësaj shtatoreje ishte momenti kulmor i veprimtarive të kësaj dite. Pas zbulimit të saj, mes duartrokitjeve të të pranishmëve dhe përlojtjes së familjarëve të Camajt, për të pranishmit përhëndeti kryetri i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" z.Ndue Sanaj.

Madhështia e personalitetit të Camajt do të mbetet përjetësisht në qytetin e kulturës në një shtatore të punuar me mjaft kujdes dhe nivel artistik nga skulptori Skënder Kraja. Një falendërim të veçantë për të gjithë ata që kontribuan dhe mbështetën këtë iniciativë të shoqatës. Me këtë rast, për disa personalitete dhe kontribues, kryesia e shoqatës shpërndau vlerësime me titullin "Mirënjohja Martin Camaj". Ia vlen të vlerësohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të Drejtorisë Arsimore Shkodër, të cilët nëpërmjet nxënësve të shkollës "Martin Camaj", përhëndetën pjesëmarrësit me disa recitime.

Ky aktivitet shërbeu si një pikë kontakti për drejtuesit e kësaj shkolle dhe ata të shkollës "Martin Camaj" Guracok të Kilinës, të cilët filluan bashkëbisedimet për një binjakëzim të mundshëm.

Por miqtë dhe të ftuarit, edhe pse me mjaft vështirësi në gumbullimin e fondeve, nuk kishin si mos ti shtronin ata në një drekë miqësore. E gjitha kjo falë mikëpritjes së Bar Restorant "Tradita GT", me pronar z.Gjon Dukgilaj dhe bujarisë së biznesmenit Gjergj Leqejza, kaluam disa orë më miqtë që kishin ardhur nga larg.

Kjo ditë tetori, që ishte edhe mbyllja e një cikli të gjatë pune për të vlerësuar veprën e Martin Camajt, do të mbetet gjatë si kujtim në memorien e secilit nga ne. Më i kënaqur se kushdo ka të drejtë të ndihet grupi i punës, i kryesuar nga sekretari i shoqatës "Atdhetare Dukagjini" z.Luigj Shyti. Ata kanë arsye të krenohen për këtë punë të mrekullueshme, e cila në historikun dhe veprimtarinë e shoqatës do të mbetet ndër më të vlerësuarat.

Për disa vite kam pasur rastin të përcjell dhe të përshkruaj nëpërmjet fotove shumë aktivitete. Sot, në këtë reportazh me pak fjalë, pak foto dhe shumë kujtime, dua të përcjell tek lexuesit atmosferën festive të kësaj dite, sepse vlerësimin historik, artistik dhe kulturor të këtij evenimenti padyshim që do ta sjellin të tjerë gazetarë dhe bashkëpunorë të shoqatës.

LULASH BRIGJA,  
Shkodër, më 15 tetor 2015

# JU LUMTË PËR PUNËN TUAJ TË MADHE DHE MIKPRITJEN

- PËRSHTYPJE NË DITËN E PËRURIMIT TË SHTATORES TË MARTIN CAMAJT -

**UKSHIN JASHARI Kryetar i Shoqatës së Vëllazërisë "Martin Dreshaj"**

Ne, delegacioni i Shoqatës së Vëllazërisë "Martin Dreshaj" i përfaqësuar nga kryetari Ukshin Jasharaj, Ali Tahiraj, Frashen e Ardit Racaj si dhe përfaqësuesit e shkolles fillore "Martin Camaj" Gurrakoc të përfaqësuar nga Mimoza Osmanaj-Kabashi, patem kënaqësi dhe nder të veçantë që u bëmë pjesë e marshit për të nderuar albanologun Martin Camaj dhe për të ngritur në piadestalin më të lartë figurën dhe veprat e tij që lanë gjurmë të përjetshme në historinë tonë kombëtare. U ndiem shumë të nderuar dhe jashtëzakonisht të kënaqur që ishim pjesë e juaja e u pritëm vëllazërisht nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në krye me Ndue Sanaj si dhe nga Luigj Shyti, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Vera Sanaj, Lulash Brigja, Aleks Dushi e shume e shume antarëve të tjerë të shoqatës. Ju faleminderojmë për mikpritjen e ngrohtë dhe për përpjekjet e parreshtura për të bërë bashkë të gjitha pjesët e atdheut tonë Si dhe nuk mundemi të kalojmë pa e faleminderuar pronarin e restuarant "Tradita" Z.Gjon Dukgilaj.

**ISMET KRASNIQI LALA - aktor**

Po sa na mbrirni ftesa nga Shoqata Atdhetare Dukagjini morëm vendim për të marr pjesë në Manifestim, një delegacion i përbër prej pesë vetave, njerëz të artit, kultuërs e letërsisë: Prend Buzhala, kritik letrar, shkrimtar e poet, Idriz Berisha piktor Akademik dhe poet, Gjon Gjergjaj skulptor, shkrimtar, poet, Ismet Krasniqi aktor profesional e krijues dhe Kujtim Millaku drejtor i Arkivit Historik në Klinë. Në orët e hershme të mengjesit u nisem nga Klina për në Shkodër. E kush mund ta merrte me mend dikur se kjo rrugë do të kalohet vetem për tri orë, mrekullia vet. Në ora 9 të mengjesit arrim në Shkodër, së pari u drejtëm drejt teatrit "Migjeni" pastaj vizituam mbi një orë qytetin e lashtë të artit e kultures, Shkodrën. Nisemi drejt vendit ku ishim të ftuar po sa u afrum te Biblioteka Universitare "Luigj Gurakuqi" rufeshëm dalin organizatorët për t'na deshiruar mirëseardhje, në ballë të pritjes ishte Ndue Sana, Katja Bregu, Lekë Lulguri, Roza Pjetri, Lulash Brigja e të tjerë. Plot miq tanë nga të gjitha viset e gjeografisë shqiptare e nga diaspora, do të pimë kafe se s' bëhet ndryshe nga organizatori. Vjen koha e fillimit të supoziumit secili që paraqitej në foltore percillej me vemendje nga të pranishmit, vet tema ishte interesant "Martin Camaj letersia ndryshe" rrallë ndonjëhere kam parë që në eveniment kulturor të percillet nga aq shume kamera televizive, kjo jep me kuptu se ka të bëjë me një figurë emblematike të letërsisë shqiptare. Moment tjetër emocional ishte zbulimi i Shtatores se shkrimtarit Martin Camaj. Aty perballë Bibliotekës Universitare "Luigj Gurakuqi" kryetari i Shoqates Atdhetare Dukagjini pas një fjalimi për jeten e veprën e

shkrimtarit, kerkoi të zbulohet shtatorja, nën tingujt e bandës së qyteit, u zbulu shtatorja e Martin Camaj, emociione, falenderime e përgëzime. Aty afer Shtatores u ndanë edhe mirënjohje per më të meri-

Marin Camaj në kuader të 90 vjetorit të lindjes. Një program modest nga shkolla 9 vjeqare Shkodër që mbante emrin e "Martin Camaj". Unë autori i këtij shkrimi bëja përpjekje me aparatim tim të mos e



tuarit për këtë veper. Delegacioni nga Klina u ndie mirë kur Prend Buzhales iu dha titulli MIRËNJOHJA "MARTIN CAMAJ". Me motivacion: Për kontributin e dhënë në promovimin e veprave të shkrimtarit, poetit dhe albanologut të shquar

lëshoj asnjë kuadër pa e fotografu e dija se ky ishte monumet historik, historisë i duhen fakte e fakti me i mire eshte fotografia. Prandaj një set fotografish do tia dhuroi Shoqates Atdhetare Dukagjini, e meriton pas një organizimi të shkelqyar.

Pasë përfundimit te kësaj ceremonie, organizatori shtroj drekë për mysafirët në një restorant të veçant, shtëpi muze, ish shtëpia e poetit Filip Shiroka. U ngritën gotat me dëshirë që të gjindemi prap së bashku nga manifestime të tilla përurimi. Siq e do rendi, organizatori në krye me Ndue Sanen me perqafime na përshëndetën duka na dëshiruar rrugë të mbarë e ne u nisem rrugës rreth Rozafatit drejt Kosovës.

U falem për këtë organizim Ismet Krasniqi Lala aktor Klin- Kosovë

**IDRIZ BERISHA - piktor, Klinë, Kosovë**

Perzemersisht ju falenderojme per mikpritjen, dhe respektin qe tregoni per ne Klines dhe njerëzit e kultures! Momente te paharrueshme nga ceremonia e inagurimit te shtatores se albanologut Martin Camaj në Shkoder! U gëzua shumë që Martin Camaj na u rikthye në vendlindje dhe kjo falë të nderuarës Shoqates Atdhetare Dukagjini dhe aktiviteve të saj në Shkoder dhe në mbarë botën! Atë që bani për letërsinë shqipe Martin Camaj e bëtë ju me këtë vepër arti, shtatore e pavdekshme per brezat! Sidomos më pëlqeu vendi që keni përzgjedh para bibliotekes Universitare për t'u shërbyer qytetarëve, studentëve dhe studiuesve të letërsisë si model! Delegacioni i Klines ishte i nderuar nga shkrimtari e studiuesi Prend Buzhala, aktori e poeti Ismet Krasniqi (Lala), shkrimtari Gjon Gjergjaj, historiani Kujtim Millaku dhe piktori e poeti Idriz Berisha!

Ky delegacion u ndie i privilegjuar pasi prof. Prend Buzhales shoqata i dha edhe një vlerësin special për kontributin e dhënë ndër vite me punën për studimin e figurës dhe veprës Martin Camaj! Shpresoj shihemi edhe aktivitete të tjera!

**Prof.dr. ZEF GJETA**

Ishte nje aktivitet i arganizuar shumë mirë, pjesëmarrje e gjërë dhe një larmi nga të gjitha institucionet. Edhe konferenca shkencore ishte e arritur, me studime të vecanta. Mu duk një gjë për tu lavdëruar në tërësinë e elementëve të vet.

**LUC BALA - Oficer në pension**

Shoqata Atdhetare Dukagjini duke nderuar bijët e shquar të vet që luftuan për çlirimin kombëtar me pushkë e me penë si kollosi i letrave shqipe Martin Camaj.... Veçse nderon veten e saj dhe mbarë Kombin Shqiptare në mbarë Botën....Unë jam shumë i emocionuar dhe nderuar që mu dha mundësia që të marr pjesë.

**NDOC SELIMI - Studiues**

Shoqata Atdhetare Dukagjini duhet të dekorohet nga Presidenti i Republikës për veprën madhore që ka bërë për ngritjen me punën e saj organizative dhe mbështetjen e dashamirësve të Dukagjinit dhe dukagjinaseve, dhe ngritjen e dy busteve te personaliteteve shqiptare Mehmet Shpendit dhe Martin Camaj. U pershendes Kryetar i kesaj Shoqate Ndue Sanaj dhe gjithë anetaret e saj si dhe gjithë kontribuesit brenda dhe jashte ku-fijeve te Shqiperise. Paçi Bekime!

Mblodhi **ROZA PIETRI**



## DAS ÖSTERREICHISCHE HONORARKONSULAT KONSULLATA AUSTRIAKE E NDERIT SHKODER

Me datën 27 tetor 2015, në Hotel "Turizmi", me rastin e festes Kombëtare dhe largimit të Ambasadorit të Austrisë, Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, zoti Gjergj dhe zonja Natalia Leqejza, së bashku me Ambasadorin e Austrisë, zoti Thomas dhe zonjën Regan Schnoll, organizuan një pritje të veçante, me pjesëmarrjen e shume personaliteteve të kulturës, të artit dhe autoritetet e pushtetit vendor e qendror.

### Fjala përshëndetëse e Konsullit të Nderit, zotit Gjergj Leqejza

*Të nderuar përfaqësues të komuniteteve fetare!  
Të nderuar drejtues të pushtetit vendor!  
Të nderuar deputete të Parlamentit të Shqipërisë!  
I nderuar shkëlqesi Zoti Ambasador!  
Të nderuar miq!*

Dëshiroj t'ju falënderoj përzemërsisht të gjithëve ju për pjesëmarrjen në Festen Kombëtare të republikës së Austrisë dhe gjithashtu t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj tashme në vitin e njëmbëdhjetë të prezencës honorarë të republikës së Austrisë në Shkodër.

Festa e sivjetshme na mbledh edhe për t'i dhënë lamtumirën Shkëlqesisë së tij, zotit Ambasador, Thomas Schnoell, i cili përveçse një bashkëpunëtor i shkëlqyer i Konsullatës së Nderit në Shkodër, është edhe miku i radhës i Shqipërisë, që na le me përshtypjet më të mira për profesionalizmin seriozitetin dhe përkushtimin që ka ky shtet karshi forcimit të marrëdhënieve me Shqipërinë e vogël, por me një dashuri të madhe për artin, kulturën dhe traditën e Austrisë. I uroj përzemërsisht mikut tim, Thomas Schnoell, shume suksese të mëtejshme në punën e tij dhe i them se, ai po merr me vete mirënjohje të madhe nga populli shqiptar për punën e tij të shkëlqyer, por edhe mirënjohjen time personale për respektin dhe vlerësimin e punës të Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër.

Gjendemi këtu, pas koncertit të suksesshëm të tenorit të mirënjohur, Agim Hushi, i cili si shume bashkëkombës të tij, në Austri, gjeten strehën dhe ambientin e duhur për t'u zhvilluar e konsoliduar si artiste të niveleve ndërkombëtare. I shpreh falënderimet e mia të përzemërta këtij artisti që Shkodrën që i zbuloi talentin, nuk e harron kurrë.

Java e festiviteteve për festën kombëtare të Austrisë, është e mbushur plot me veprimtari, të cilat u hapen nga Shkolla Austriake në Shkodër "Peter Mahringer", me datën 26 tetor me një koncert të shkëlqyer artistik, vazhduan me koncertin edhe në teatrin "Migjeni", të tenorit Agim Hushi, dhe përmbyllen me aktivitetin "Austria lexon", me shkrimtarin Austriak me prejardhje shqiptare Ilir Ferrën. tek Biblioteka Austriake me datën 28 tetor 2015.

Ketë vit, në fokusin e veprimtarive të Konsullatës së Nderit, janë arsimit dhe çështjet sociale, dhe për ketë arsye, dëshirojmë që në ketë feste të sivjetshme të përkujtojmë dhe vlerësojmë punën e tre sipërmarrjeve direkt ose indirekte të Austrisë

në Shkodër:

Shkolla austriake Peter Mahringer, e cila ka instaluar një perspektive krejt të re, për të rinjtë e qytetit dhe rajonit verior, duke i dhënë mundësinë që të aftësohen në teknologjinë e informacionit; të marrin një formim të niveleve të bashkimit evropian; të përvetësojnë kulturën e një nder vendeve më mbizotëruese të Evropës; dhe të integrohen lehtësisht në mjediset akademike të Austrisë.

Shoqate jo fitimprurëse ASTA, e financuar nga donatore Austriake, kujdeset për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara dhe me probleme ekonomike. Kjo shoqate i ofron këtyre fëmijëve asistencë psikologjike dhe akademike, ushqim, rehabilitim dhe synon ti integroje ato në shoqëri, që të jene të barabarte me bashkëmoshatarët e tyre.

Grupi i vullnetareve Animals Need Me, i cili ka gati tre vite që kujdeset për ato që të gjithë ne i harrojmë lehtësisht, për kafshët endacake të Shkodrës, duke i dhënë përkujdesje, strehim dhe trajtim mjekësor rehabilitues. Ky grup, i ndihmuar vazhdimisht në forme të organizuar nga qytetare të Austrisë, synon të çojë në 100% normën e sterilizimeve duke ulur kështu edhe rrezikun publik që mund të shkaktojnë kafshët e pa trajtuara. Këto vajza përveçse japin një shembull të rrallë të punës vullnetare indirekt na japin edhe shërbim publik të vyer.

Kjo është fryma që sjell Austria në Shkodër dhe unë jam krenar që të përfaqësoj një komb me kaq shume dimensione kulture, zhvillimi dhe humanizmi dhe jam po aq krenar për lidhjet mes kombeve tona që po forcohen dita-ditës dhe një tregues konkret është dhe pjesëmarrja e përvitshme juaja, për të cilën edhe një here ju falënderoj në emër të Konsullatës së Nderit, në emër të Ambasadës dhe timin personal!

Ju uroj çdo të mire për ju e familjet tuaja!

Edhe një here gëzuar Festen Kombëtare të Austrisë!


Faleminderit!

# NJË RIKTHIM NË HISTORI

## - PROMOVIMI I LIBRIT, HISTORIA E SHQYPNIS, TË AUTORIT DOM NDOC NIKAJ -

Me datën 17.10.2015, në sallën Kardinal Mikel Koliqi u bë promovimi i ribotimit të veprës së Dom Ndoc Nikaj "Historija e Shqypnis" vëll. I - II, Bruksel (1902), Shkodër (1917), organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Famullia e Shkodrës. Kjo vepër erdhi në vazhden e viti Jubilar të 25-vjetorit të Meshës së Parë në Shqipëri, kremtuar me 4 nëntor 1990, në varrezat e Rrmajt nga Dom Simon Jubani, që po organizohet nga Kryedioqeza e Shkodër – Pult, përkatësisht Famullia e Shkodrës. Pas fjalës përshëndetëse të famullitarit Dom Artur Jaku, për vlerat e kësaj vepre, folën personalitete të rëndësishme të kulturës, nga Universitetit i Shkodrës, të cilët përmes kumtesave të tyre, hodhën dritë mbi këtë vepër të lënë deri tani nën hije të kohës në mënyrë të pamerituar. Dom Ndoc Nikaj si romancier i parë shqiptarë, gjithë jetën e tij ka punuar për një mirëqenieje shpirtërore e kulturore përmes rritjes së vetëdijes kombëtare. Ka shkruar mbi 400 shkrime, 30 vepra të botuara dhe 7 romane të pabotuara. Nikaj është një jetë e tërë e kaluar në shërbim të të tjerëve, dhe e përfunduar në persekutim në vitin 1951, u theksuar nder të tjera nga studiuesit e pranishëm. Historia e Shqypnis, është një mundësi për të njohur të vërtetën tonë të cunguar edhe në këto vite lirie, gjithashtu është një nxitje për të ndriçuar këto figura nën dritën e të vërtetës e të vlerësimit.

MARINELA BUXHA



# Me vëllezërit e Martin Camajt

- Kujtime -

Që në femininë time të hershme, prindërit e mi dhe mjaftë burra të Shllakut më kishin folur për fisin Camaj, në Telume, brenda një kooperative dhe këshilli të bashkuar me Shllakun. Ndërsa kontaktet e para me këtë fis i kam pasur mbasi mbarova shkollën e mesme bujqësore në vendlindje, në Shllak dhe u emërova agronom në sektorin e katërt në Temal, në vitin 1983. Aty për herë të parë, edhe pse nuk ishim në një sektor, pjesa e Temalit të poshtëm i përkiste sektorit ku unë punoja, u njoha me Gjergjin, Zefin dhe Markun, vëllezërit e Martinit, që jetonin në një kullë mes malesh të larta, që i ngjante një amfiteatri gjigand natyror.

Gjergji shquhej për kuraja e zgjuarsis natyrale, që asnjëherë nuk tentoj të mohonte vëllain e tij të madh, Martinin e mërguar jashtë Atdheut, në Gjermani! Gjatë netëve të punës time si agronom dhe më pas si mësues, në vitet 1989 në Telume, pata mundësinë të njihesha më mirë me fisin e tyre, të Camajve. Nuk mund të fshij dot kurë nga kujtesa rrugën që bënte Gjergji rreth 1 orë në këmbë nga kulla e tij për të ardhur tek unë mësuesi fshatit të bisedonim gjithë natën për jetën, dhimbjet dhe dashurinë që ai ndjente për të vëllain e larguar dhe të mohuar nga pushteti i kohës. Një dhimbje e heshtur dhe e mbyllur brenda vetes, që vetëm ai e dinte sa gërryese dhe therëse ishte. Kur vinte tek unë, ai nuk e fshihte dot atë dhimbje që ndjente, përkundrazi zbrazej para meje, sepse kishte nevojë të zbrazej që të ndjehej sadopak i lehtësuar nga ajo brengë që ishte ndry brenda vetes me vite të tera.

Nga kjo trysni, ai ishte i detyruar të bënte jetën e një kaçaku jo vetëm në fshehjen e dashurisë për të vëllain e anatemuar nga regjimi, por edhe për të ndihmuar edhe dy vëllezërit e tjerë më të vegjë, Zefin dhe Markun e madje edhe nipin, Mirashin. Për rritjen dhe daljen e tyre në jetë, ai detyrohej të mbante bagëti fshehurazi në shpella për të mos u diktuar nga pushteti vendor, sepse nuk lejohej mbajtja dhe kultivimi i pronës private, pronë pa të cilën ai nuk mund të përballonte dot jetën e tij dhe të vëllezërve, që duheshin ushqyer e rritur për të mos e humbur emrin e fisit Camaj, një emër e fis i nderuar.

Nga Gjergji kam mësuar për Martinin, që ka qenë fëmijë i zgjuar dhe me prirje të veçanta, që bënte të mendohej se ishte një fëmijë me të ardhme intelektuale, por që në ato kushte fshati malor, nuk mund ta arinte atë yllësi që e priste në jetë dhe për ta arritur atë shtysë u detyrua të emigronte për të gjetur rrugën e duhur për tu formuar ashtu si e meritonte. Një ditë, më thoshte Gjergji, rastësisht kalon pranë shtëpisë tonë frati i Duzhmanit, Patër David Pepa, famullitar. Ai shikon në disa rrasa guri disa shkrime fëmijësh që ruanin bagëtitë midis të cilave i tërhoqi vëmendjen një shkrim, që atij i tërhoqi vëmendje te veçante,

Martin Camaj, përgjigjet ai djalë i vogël, i cili duke qenë para fratit nga emocionet e frika, po i dukej vetja edhe më i vogël se ç'ish.

Ti, i thotë Frati duhet të shkosh në shkollë në Shkodër, dhe bashkë me të morën rrugë-tuan për në shtëpinë e Kol Camajt, për t'ia shtruar edhe atij prirjen që kish ai fëmijë, duke i sugjeruar, se duhej ta çonte në shkollë, sepse ishte një fëmijë me prirje të veçanta. Duke i besuar Fratit, Kola ra dakord për ta çuar në shkollë djalë. Por Frati dhe mbas kësaj nuk hoqi dorë nga interesimi i tij për ta ndjekur nga afër, për të zbuluar talentin e atij fëmije, talent që ai e kish shfaqur në ato rrasa guri, që veç një intelektual si David Pepa mund ta zbulonte. Dhe ja, ai djalë u bë një nga lëvruarit e shquar të letrave shqipe jashtë Atdheut.

Martin Camaj lindi më 21 korrik 1925, në fshatin Telum, të krahinës së Temalit. Por fati e deshi të jetonte dhe punonte deri sa vdiq larg vendlindjes, në Bavarinë e Epërme, në fshatin Lengriz të Gjermanisë, ku edhe vdiq më 12 Mars 1992, në moshën 67-të vjeçare, pranë të shoqes Dr. Erik Camaj. Një vdekje, që pengoj ardhjen e tij të shikonte edhe njëherë vendin ku lindi dhe shfaqti shenjat e para të një njeriu me të ardhme të shquar, por që fatkeqësisht mbeti jashtë hapësirave shqiptare, ashtu sikurse mjaft intelektual të tjerë të shquar që kanë bërë emër në botë, por që fatkeqësisht mbetën të panjohur apo të anatemuar në vendin e tyre, sepse nuk e kanë dashur izolimin e sistemit komunist.

Lajmi i vdekjes së tij sigurisht që i trishtoj shumë vëllezërit, të afërmit dhe krejt Dukagjinin, që nuk arriti të shiheshin qoftë edhe njëherë ndonëse muri i izolimit tashmë ishte shembur dhe bashkë me të "mëkatit" i tij ishte kthyer në vlerë për të dhe tere nacionalitetin shqiptar! Kështu që mbas asaj ngjarje të dhimbshme ardhur para kohe, vëllezërve nuk u mbeti gjë tjetër veçse të respektonin vdekjen dhe traditën e maleve në organizimin e ceremonisë mortore pa



trupin e tij. Në këto rrethana, familja Camaj u detyrua të hapte gjemën për vdekjen e vëllait të madh në moshë, të madh në mendimin intelektual, por edhe të dhimbshur, sepse ndërroj jetë larg njerëzve të dashur, fshatit dhe Dukagjinit të tij.

Isha prezent në këtë ceremoni paksa të veçantë në llojin e vet, ku ngjarja dhe trupi

qëndruan në Gjermani ku ai u rrit, u shkollua, punoj dhe krijoi familje deri sa vdiq i lodhur nga malli dhe sëmundja e rënd që i mori jetën. Ndërsa në oborrin e shtëpisë ku lindi, në mungesë të trupit, vendosën rrobat dhe në vend të kësulës së bardhë, një nga librat e krijimtarisë e tij, si simbol i dijes dhe dashurisë për Shqipërinë dhe Dukagjinin, që i deshi dhe i ndiqte së largu si një engjëll mbrojtës. Një skenën e dhimbshme që nuk mund të qëndronte dot askush pa u ndjerë keq dhe derdhur lot, për atë birë të fshatit të tyre me aq emër, por i mohuar nga regjimi komunist, që meritonte shumë e më shumë se aq sa po i kushtohej atij kolosi të letrave shqipe, pas vdekjeje. Rrezja e pjesëmarrësve në atë ceremoni mortore ishte e gjerë, përtej kufijve të Dukagjini dhe Shkodrës, deri në Pukë, Malësinë e Madhe e deri tek miku im nga Britania Rhodri Jons, i pari përfaqësues i mediave të huaja që shkelte në malësi pas rënies së komunizmit, që fotot e kësaj ceremonie i shpërndau po thuaj në të gjithë botën, sepse edhe Martinin ishte i këtyre përmasave.

Në verën e atij viti, në Shqipëri erdhi dhe e shoqja, Dr. Erika, e cila kishte vendosur ta shikonte vendlindjen e të shoqit, së paku mbas vdekjes, me që para saj nuk mund ta lejonin, sepse ishte si një herezi ta mendoje një vizitë të tillë. Ceremonia për atë grua të huaj, por nuse tek Camajt, padyshim që meritonte një pritje të denjë duke angazhuar jo vetëm familjen e vëllezërve të burrit, por edhe këshillin e komunës Shllak, në një ambient të zgjedhur si ai në Fushë të Liqenit, në Cukal. Në atë pritje Zonja Eriko shoqërohej nga prefekti Shkodrës, Anton Berisha, një nga ish nxënësit e Martinit, ndërsa fjalën përshëndetëse e mbajti kryetari i Komunës, Bardhok Zhuri. Ajo drekë shumë simbolike dhe tradicionale, e organizuar me shpenzimet e komunës, kaloi në një atmosferë teje emocionale sepse, po përziheshin dy krushqi, me nusen midis tyre paqka se dhëndri nuk jetonte më, jetonte vepra, gruaja e tij dhe vëllezërit e të afër-

pjesëmarrësit u nisën drejtë kullës së Camajve, mbushur me njerëz brenda e jashtë saj, sepse mbarte një motiv... kishte ardhur nusja e djali pa djalin për të shkëlur në shtigjet ku ishte rritur e vrapuar ai ne kohen e fëmijërisë e deri në nisjen e rrugës së dijes nëpërmjet studimeve, sa u bë dikush që nderonte jo vetëm fisin, por fshatin, Dukagjinin dhe gjithë Shqipërinë. Kjo ishte ajo që e bënte atë njeri të pavdekshëm edhe pas vdekjes.

Jo më pak emocionale ishte dhe momenti i ndarjes së asaj gruaje nga vëllezërit e bashkëshortit, që për aq pak kohë sa ndenji me ta u miqësua sa i detyroj të përloreshin në momentin kur ajo u jepte dorën e përcjelljes dhe largimit nga ai fshat dhe zonë. Gjergji ishte ai që ndjehej më keq në ato momente ndarje, si vëllai më i madh, që jetonte dhe ruante më shumë kujtime për Martinin, që nuk ishte më pran tij. Me

lot në sy, ai i shpjegonte dhe tregonte kunatës Erikë, vendet ku i vëllai kish kaluar fëmijërinë dhe rininë e tij, madje dhe vendin e rrasave ku frat David Pepa kish zbuluar talentin premtues të atij fëmije. Për të treguar shpirtin e tij human e besimtar, Gjergji i tregoj Erikës dhe vendet ku Martinin kishte ndërtuar kryeq prej druri në shtigjet ku kalonin shtegtarët për tu orientuar në rrugëkalimet e vështira malore në atë zonë. Dhe për ta sjellë të gjallë kujtimin e tij, ai i kishin ndërtuar sërish ato simbolika kato- like, atë të kaluar të largët te të vëllait të mbetura në kujtesë.

Pas një jave 'bashkëjetese', Erika me vëllezërit e të shoqit lanë Telumen, Temalin dhe zbritën në Kishë-Anë për të kapur anien e linjës Fierz – Koman, ku para syve të saj, shfaqet një tjetër bukuri e rrallë shqiptare, që natyra i ka falur këtij vendi sa të ashpër aq edhe magjik në bukurit e tij. Aty kishte dalë për ta pritur mbesa e Martinit, Tali (e cila nuk jeton me), që nga ai moment e mori ajo përgjegjësinë për ta shoqëruar në vendet ku kish kaluar e punuar Martinin.

Për vendlindje dhe jetën e Martin Camajt kam dhënë edhe unë një kontribut modest, sidomos në përgatitjen e një dokumentari së bashku me mikun tim nga Britania e Madhe, Rhodri Jons dhe transmetuar në kanalën prestigjioz BBC. Gjithashtu jam mirënjohës ndaj gjithë anëtarëve dhe drejtuesve të shoqatës atdhetare "Dukagjini" për përgatitjen dhe vlerësimin e dhënë me rastin e 90-të vjetorit të lindjes së intelektualit të shquar shqiptar Martin Camaj, bir i zonës tonë, të cilit i kushtuan një Konferencë shkencore, me temë "Camaj-Letërsia tjetër" dhe i ngritën edhe një monument, me përmasa: bazamenti 1. 2 metra, monumenti 2. 5 metra dhe gjithsej 3. 7 metra!

Nw gazetwn "Jeta e Re" tw datws 20 qershor 1991 shkruhet: "Ka disa ditë që vëllezërit Camaj këtu në Shllak përjetojnë çaste gëzimi krejt të veçanta. Bisedoj me tre vëllezërit. Gjergjin, Zefin e Markun. Ka pak kohë që kanë marrë në dorë gjithë librat që mbajnë për autor vëllain e tyre, Martinin.

Martin Camaj! Një emër deri dje thua- jse krejt i panjohur për arsye që tashmë di- hen. I panjohur për ne, por jo për botën ku tashmë është afirmuar si një personalitet i shquar i kulturës shqiptare, me një veprim- tari të gjerë letrare e shkencore.

Ndaj dhe ndjehen krenar vëllezërit Camaj. Ndaj dhe vëllai i madh, Gjergji ka të drejtë kur thotë: "Këto libra që na ka çue Martinin janë për ne pasuria më e madhe..."

Përgatiti ZEF NIKA,  
Belgjikë, me 20.10. 2015

# Shërbim, dashuri dhe shpresë për personat me aftësi të kufizuar

Më 24.10.2015, në ambientet e Teatrit Migjeni, Shoqata "Projekti Shpresa" pati kënaqësinë që të mbledhë së bashku, dashamirë, kontribues, drejtues, punonjës, të rinj e të reja të Shoqatës "Projekti Shpresa" dhe jo vetëm, që na nderuan me pjesëmarrjen e tyre për të festuar '20 vjetorin' e themelimit të saj. Ishte tejet emocionuese të përkujtohej se pikërisht 20 vite më parë në tetor të vitit 1995, ka filluar një mision historik dhe human në përkushtim të personave me aftësi të kufizuar nga një asistente sociale, vullnetare, pikërisht nga e ndjera Dr. Silvana Vignali, një grua kjo që gjithë jetën e saj e kishte kaluar në shërbim të tjerëve, veçanarisht të atyre që kanë patur më shumë nevojë në Itali, në vitin 1994 ajo vjen në Shqipëri për t'ju përkushtuar një kategorie të parajgjyqar e thajse të përjashtuar nga shoqëria civile, atyre të personave me aftësi të kufizuara. Kështu, asaj i ka mjaftuar një vizitë në Institutet Psikiatrike dhe Jetimore Shtetërore për të kuptuar se sa e nevojshme ishte t'i përvishet punës në shërbim të këtyre personave për të ofruar një model ndryshe në trajtimin e tyre dinjitoz duke krijuar kështu modelin e Shtëpisë – Familje. Një ambient ky ku gjejnë përgjigje problemet e tyre, ku ata ndihen të dashur e të vlerësuar. Çdo ditë e saj që në vitin 1994 deri në ditën e saj të ndarjes nga jeta (14 shkurt 2012), që e mbushur me shërbim e punë të palodhur, me përkushtime dashuri, me sakrificim e këmbëngulje me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre si çdo qytetar tjetër. Ajo me punën dhe jetën e saj tregoi se veprat japin fryt atëherë kur veprojmë me dashuri. Projekti Shpresa nëpërmjet aktivitetit të titulluar "Shërbim, dashuri dhe shpresë" jo vetëm ka përkujtuar por ka njohur progresin që është bërë. Ky 20 vjetor përfaqëson një rrugë tranzitore dhe udhëtimi është në vazhdim pasi pa dyshim konsiston në një shërbim human të palodhur dhe të pashterrshëm. Aktiviteti u hap nga dokumentari "Një zë i heshtur shprese" i përgatitur me mjeshtëri nga Valmir Hysa, Ergys Kavaja dhe Klodjan Bregu, në të cilin u paraqitën fakte historike që me krijimin e shtëpisë së parë familje e deri aktualisht, u paraqitën dëshmi nga të rinj e reja me aftësi të kufizuar që jetojnë në Shtëpitë- Familje dhe nga kujdestarë social të cilët u shprehën për ndryshimin pozitiv të jetës së të rinjve. Pas hapjes së aktivitetit nga psikologjia klinike e Shoqatës Znj. Suela Ndoja dhe punonjësi i Qendrës Ditore Z. Tomas Delia, fjala iu dha Presidentit të Shoqatës "Projekti Shpresa" i cili falenderoi të pranishmit dhe bashkëpunëtorët dhe kontribuesit që kanë ndihmuar për ta çuar përpara misionin dhe objektivat që Shoqata mbart lidhur me përkujdesjen sociale të personave të cilët janë të braktisur dhe jo vetëm kaq. Z. Mila ia dha fjalën Arqipeshkvit. Mons. Angjelo Masafra i cili përshëndeti përzemësisht dhe

mbi të gjitha vlerësoi punën e palodhur të Z. Mila. Gjithashtu bekoj punën që bëhet nga i gjithë stafi i Projekti Shpresa nga përfshirë kujdestarët social duke tërhequr edhe vëmendjen e instancave më të larta për ecurinë e mëtejshme. Z. Mila vijoi duke e vlerësuar mbështetjen dhe kontributin e tij të përhershëm me një certifikatë mirënjohjeje. Më pas Z. Mila ftoi qytetaren e parë të qytetit, kryebashkiaken Znj. Voltana Ademi e cila na nderoi me praninë e saj aq më tepër kur prania e saj ka qënë e përhershme në ndihmë të Shoqatës. Shërbimi ndaj të rinjve e të rejave me aftësi të kufizuar përbën një mision të bekuar dhe për të realizuar këtë mision human, kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë shumë persona saqë na bën të ngjasojmë me një forum të hapur për këdo që është i interesuar dhe tregon dashamirësi në realizimin e tij. Ndër ta ne përmendëm: *Comitato della lotta contro la fame nel mondo, Progettiamo la Speranza, Gruppo India, Caritas di Madrid, Soidarieta senza Confini, Fondazione Entreculturas, Missione San Lorenzo, Diocezi di Grosseto, Caritas Terra del Sole, Cafod, San Giovanni Batista di*

vijim fjala iu dha Drejtoreshës së Shërbimeve Sociale, Znj. Valbona Tula, nga sektori i shëndetit mendor, një përfaqësuesi të mjekjes psikiatre Dr. Valdet Hoxha, nga sektori i shëndetit të përgjithshëm dhe mjekes së familjes. Dr. Vilarta Thaçi. Në sallë ishin të pranishëm përveç të rinjve e të rejave të shtëpive-familje të Projekti Shpresa të shoqëruar nga kujdestarët social edhe përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Sociale, Bashkia Shkoder, Zj. Rudina Kruja, Zj. Jeta Xhabija, nga Qendra e Zhvillimit Shtetëror, ish drejtore Zj. Marije Koliqi dhe logopedja Zj. Linda Duro, nga Shoqata "Madonnina del Grappa", Koordinatori. Fabrizio Nocchi së bashku me stafin profesional, kujdestarët e të rinjtë e të rejat me aftësi të kufizuar të kësaj Shoqate, nga Instituti i Motrave të Nënë Terezës, përfaqësues, kujdestarë social dhe vajzat e këtij Instituti, nga Instituti i Motrave Stigmatine dhe përfaqësues të famullive dhe OJQ-ve të ndryshme dhe individë nga Shkodra dhe Tirana. Ndër të tjerë mund të përmendet edhe prania e Kryetarit të nderuar të Shoqatës 'Dukagjini', Z. Ndue Sanaj. Programi socio-artistik u hap me këngën "Si

ve të të ndjerës Silvana Vignali dhe theksoi gjithashtu edhe frutet e punës si rrjedhojë e shërbimit psikologjik. Programi vijoi me një recitim të titulluar: "Ëndrra" nga të rinjtë e Projekti Shpresa, Leonard Marku, Megina Mjeshtri dhe Romario Meta. Më pas u pasurua nga një performancë e vajzave të Institutit të Motrave të Nënë Terezës nën tingujt e këngës 'Zoti im' të këngëtarit tonë të mirënjohur Ardit Gjebrea, të përgatitura me dashuri dhe mjeshtëri nga Zj. Adriana Marku. Performanca e titulluar: "Qiriu i Shpresës" solli mesazhin e dhënë nga të rinjtë e Projekti Shpresa se shpresa është drita e pushuar që na përcjell tek drita e amshuar. Vazhdoi programi me një këngë 'Arbëreshe' të performuar nga një talent i ri, pikërisht Angjela Baqli, nxënëse në shkollën nëntëvjeçare "Zemra e Krishtit". I riu i Projekti Shpresa Skender Berisha, interpretoi pjesën e titulluar "Falenderim". Më pas për kënaqësinë e të pranishmëve, Xheni Alia, një talent premtues, nxënëse në shkollën nëntëvjeçare "Mati Logoreci" këndoi këngën "Mes jush është dashuria" të këngëtares sonë të mirënjohur Mira Konçit. Më pas vogëlushi i talentuar, Piter Delija interpretoi poezinë "Me gjithë shpirt". Aktivitetin socio-artistik e zbuloi në vazhdim grupi i të rinjve të Familisë Zoja Rruzare, Bardhaj me një valle me motive veriore. Në vijim, Z. Tomas Delia interpretoi "Non sono straniero" (Mos më quaj të huaj) të autorit të mirënjohur Rafael Amor. Të rinjtë e Projekti Shpresa Klodjan Kodra dhe Armelinda Buraku lexuan me ndjeshmëri prozën e titulluar "Dashuria". Aktiviteti socio-artistik u mbyll me 'Mesazhin e dashurisë nga fjalët e Shën Palit' të performuar nga të rinjtë e të rejat e Projekti Shpresa. Ky mesazh në mënyrë të thjeshtë dhe efektive përmbodhi arsyen përse ishim të mbledhur të gjithë së bashku. Nëpërmjet shërbimit përkujdesës, të dhurojmë dashuri dhe shpresë, pasi një botë ndryshe vjen në kohë kur gjërat të bëhen në mënyrë të tillë. Psikologjia klinike, Zj. Suela Ndoja vuri në dukje së fundmi që gjithëpërfshirja kuptimplotë e të rinjve e të rejave me aftësi të kufizuar në të gjitha fushat e jetës që mbështetet nga Projekti Shpresa synon në arritjen e potencialeve të tyre por kjo rezultoi edhe në përfitime sociale më të gjera. Në mbyllje përsëri mori fjalën Presidenti i Projekti Shpresa i cili ndër të tjera falenderoi organizatorët e aktivitetit Zj. Suela Ndoja dhe Z. Tomas Vata për përkushtimin dhe punën e tyre si dhe gjithë kontribuesit dhe mbështetësit e Projekti Shpresa duke uruar më të mirën dhe jetëgjatësi për projektin në mënyrë që shpresa të vazhdojë të jetë e pranishme për personat me aftësi të kufizuar. Së fundmi, Z. Mila shpërndau certifikatat e mirënjohjes për të gjithë kontribuesit dhe mbështetësit e përhershëm të Projekti Shpresa.

**Grupi Organizativ i Shoqatës PROJEKTI SHPRESA**



Campagnatico, Caritas Shqiptar, Caritas Shkoder e shumë e shumë famulli, shoqata dhe individë qoftë nga Italia, Spanja apo Shqipëria lista e të cilëve do të ishte e pafundme. Ndër ta na nderoi prania e Z. Paolo Trubiano, President i Shoqatës "Progettiamo la Speranza" (Projektojmë shpresën). Më pas edhe ai u nderua me një certifikatë mirënjohjeje dhe iu dorëzua nga psikologjia klinike e Shoqatës. Në

dukati i vogël je" nga Oligert Isanllari. Më pas u dha mesazhi i performancës "Pema Humane Universale" nga të rinjtë e të rejat e Projekti Shpresa që nëpërmjet shërbimit përkujdesës dhe dashurisë mund të ndërtohet jetë. Më pas u ftua një kujdestarë sociale e Projekti Shpresa, Znj. Violeta Çeklia e cila shprehu përmirësimin e eksperiencës së tyre në punën që ata bëjnë në sajë të udhëzimeve dhe sugjerime-

# MALI, SHPRESA DHE DASHURIA

MENDIME, KOMENTE DHE KONSIDERATA PËR VËLLIMIN POETIK "LAMTUMIRË MOS THUAJ" TË LUIGJ SHYITIT

(Vijon nga numri i kaluar)

Tërësisë së dashurive dhe mallit për Thethin e mbarë Dukagjinin, poeti, pas disa kohe i kthehet përsëri me poezinë "Vendi im":

"...Ndarja dhe largësia..." mbretëri të mëdha dhe aq të pa shpirt, e më pas shprehet me të madhe dashurinë për vendlindjen e vet edhe pse i larguar disi, se:

"Ajo është thellë në shpirtin tim,  
...  
Me besim dhe plot dashuri,  
Për ty o i miri, i dashuri, vendi im"

Duke lexuar këtë libër me mjaft interes, gjen poezinë me titull "Mall" që bashkë me "Mirupafshim" dhe "Vendi im", përbëjnë tripletin më të bukur kush-tuar vendlindjes nga poeti.

Malli i poetëve për vendlindjen s'ka të sosur. Kjo është një dukuri, mendoj unë, e përbotshme. Largimi nga vendlindja, qoftë edhe e përkohshme, të shkakton emocione të thella. E kam provuar vetë, por djali im e ka shprehur më qartë e bukur, në një poezi kur ishte për studime në Shën Peterburg me titull "Më fal Atdhe", kur shprehej:

"Si s'mundem mendjen ta largoj,  
Prej kësaj tokëze të bekuar,  
Ndryshe, t'partë e fis do mohoj,  
Si shpirt i përzënë e i mallkuar..."  
(Nga vëllimi "Udhëve në stuhi")

Kështu, ndjenja e largimit, poetët, i mundon, i shqetëson, por edhe i frymëzon, nga se shpirti i tyre është më i thellë, më i gjerë, më human e njerëzor. Kështu poeti ynë, Luigji, në poezinë me titull "Mall" i kthehet kohës që herët, atyre përjetimeve të fëmijërisë, adoleshencës e rinisë.

"Për vendlindjen time malli më ka marrë,  
Për rrugët ku edhe zbatuar kam ecë, ..."

Më pas na thotë se e ka marrë malli për rrugën e shkollës, për prrenjë dhe ortekët e borës, për shokët e fëmijërisë, për themelet e shkollës, e "Ti ledhatoj me dorë, e kokën të mbështes" që më mirë e thotë poezia sa goja kur e lexon. Është interesant dhe mjaftë e bukur se, edhe pse poezia është vetëm 52 vargje ka një hapësirë të thellë në vite, dhe shpirtin e poetit, e cila sa vjen e rritet nga niveli dhe emocionet nga strofa në strofë e nga vargu në varg.

"Më merr malli për lulet e kumbullës,  
E për aromën e ftoit në oborr,  
Më merr madhi për themelet e kullës,  
Vendosur nga prindërit e mijë me dorë..."

e si për finale të poezisë na tregon dëshirën për të pasur krahët e shqiponjës, që të shkojë atje sa herë dëshiron:

"Më merr madhi të largohen që këtej,  
Në vendlindjen time, shpesh, të shkoj,  
Por, nuk pranon shqipja krahët të mi japë,  
Ajo e di se më nuk ja kthej."  
(Nga poezia "Mall")

Kjo poezi, për synimin që ka, është nga më të bukurat e poetit në këtë vëllim, por radhitet edhe ndër poezitë më të mira e çdo peti shqiptar, që i kushtohet vendlindjes. Kjo, mendoj unë, e ka burimin pikërisht tek vlerat e çdo populli që fillojnë nga themelet e kullës, tek rrugët e arat, tek malet e kullotat, tek nënë e babai, tek shkolla e dituria, e më pas deri të krahina e i tërë vendi i tij. Kjo poezi me ngjason me mallin e Rilindëseve, kur, të

detyruar, jetonin larg vendit të tyre. Është e njëjtë, për nga emocionet me atë të Mjedës, Asdrenit, Çajupit, e pse më ngjason edhe me poezitë e mallit të poetit hungarez Sh. Pëtefi, me poetin rus Isakovski etj.

Nga përvoja shekullore e popullit tonë, nga formimi dhe botëkuptimi im jetësor si pasardhës, si prind e gjysh, arrijë në përfundimin se titujt prindëror; nënë, baba dhe të tjerë si vëlla, motër, djalë a vajzë, e duke vazhduar në vijimësinë e tyre të gjakut, nuk janë thjeshtë tituj nderi, por mbi të gjitha, prej tyre, rrjedhin detyrime jo vetëm ligjore, por mbi të gjitha detyra dhe larje borxhesh ndaj brezave të kaluar, për sakrificat që ata kanë bërë në dobi të mbarëvajtjes të jetës së brezit vijues. Prej shekujsh këta ekuilibra, te shqiptarët, e më mirë se kudo edhe në Dukagjin, kanë shërbyer si vlera të pa zëvendësueshme në mbarëvajtjen e shëndetshme të familjes tonë. Pikërisht, kjo më erdhi në kujtesë, kur po lexoja poezitë e Luigj Shytit kush-tuar prindërve dhe fëmijëve të vet. Poezia "Më fal baba" me të cilën kemi çelë këto mendime dhe komente, më imponoi paragrafin e mësipërm, ku lexova një ujëvarë të tërë me elegji kushtuar babait. Kjo më bëri përshtypje edhe për faktin e një ndjenje deri në shenjtëri të djalit për babin e vet, por edhe për faktin se poezitë kushtuar babait janë më të radha se për nënën. Poetët më të mëdhenj të botës, tek krijimet e veta për nënën kanë derdhur tërë plazmën e shpirtit. P.sh. në Itali pas Luftës së Dytë Botërore, janë shkruar me mijëra e mijëra poezi e nga këto poezi janë kompozuar dhe kënduar rreth 420 këngë kushtuar nënës ose nënave. Për baballarët janë më të radha. E

radhë për nga bukuria dhe emocionet që përcjell është edhe poezia e L. Shytit "Më fal baba", për të cilën po flasim. Djali nuk e ka harruar aspak babin e tij. Ndjenjat që përjeton djali, konkretisht autori, te varri i të atit, i ngritur në amanet poetik, si dëshmi jo vetëm e përjetimeve të veta, por edhe si vlerë e pazëvendësueshme dhe e paharrueshme e babait të vet, e pse jo edhe për tërë ata të tjerë që i kujtojnë prindërit apo bëhen vetë të tillë, Autori e mbyllë poezinë e tij me vargje të fuqishme:

"...Është mbas dite, vonë ka shkuar,  
Më fal baba, se jam vonuar,  
Vështrimin hedh nga malet,

Ndërsa po lexoja poezitë e Luigjit kush-tuar babait pranë varrit i tij, mu kujtua një poezi e poetit Rus, Vasili Kazin me titull "Në varrin e nënës", prej të cilës po shkëpus këto rreshta:

"Nga zhurm' e val' e Moskës qytetare,  
Të erdha sot, e varfëra ime nënë,  
Në këtë vend të heshtur, mbushur varre,  
Në këtë vend ku eshtrat të kan' rënë,  
...  
Lule të shtrenjëta përmbi varr të ftohtë,  
Të solla sot ... Po ti ç'm'i flet tët biri,  
"Ç'harxhon o bir? Kënaqet nëna jote,  
Edhe nga luleshqerkat e çairit.  
Po unë hesht ... dhe zemrën, nënë moj,  
Plot zjarr do të ta vija përmbi lule,  
Dhe qaj' e qaj' ... gjithçka  
kur të kujtoj,  
Mbi varrin tënd të  
shkretë ku përulëm."

I solla këto poezi, e në këto shënime modeste për librin e Luigj Shytit "Lamtumirë mos thuaj", jo vetëm për të treguar ngjashmërinë e poetëve, në kohë e vende të ndryshme, pa takur, as pa lexuar kurrë njëri tjetrin, por edhe se aq sa larg janë nga distanca, po aq afër janë për ndjenjat dhe emocionet, por edhe për mesazhet që përcjellin edhe si amane të pavdekshme për brezat e ardhshëm të lexuesve, poezi të cilat kanë në brendinë e tyre mallin, lotët, vlerat e prindit, por edhe amanetet për fëmijët e vet.

Ashtu si poezitë kushtuar babait, nënës, fëmijëve dhe çdo poezi e këtij vëllimi të Luigjit, duken qartë si drita e diellit dy linja; ajo e sinqeritetit shpirtëror dhe ajo e realitetit jetësor. Këto dy cilësi të poetit tonë, janë jo vetëm vlera për tu veçuar e vlerësuar, por janë edhe të domosdoshme për çdo poet e

shkrimtar, nëse dëshiron jetëgjatësinë e veprës së vet. Të jesh realist, do të thotë të jetosh e të krijosh realitetin me kohën, të ecësh hap pas hapi me të, me hallet dhe shqetësimet, me njerëzit dhe dhimbjet që ka individi, familja dhe shoqëria jonë në përgjithësi, atdheu dhe kombi, duke i pasqyruar realisht në krijimtarinë tënde. Të jesh i sinqertë shpirtërisht në krijimtari do të thotë të shkruash me besnikëri për atë dhe ato që ti ndjen, që vlerëson dhe gjykon, dhe në se ato që shkruan të jenë të pandara nga jeta e shpirtit të popullit tënd dhe idealeve tua, pavarësisht nëse u pëlqejnë ose jo mendimet e tua kundërshtarëve qofshin ata në krijimtari, politik a



Ty duke të përfytyruar."

Nderimi për brezat e kaluar, veçanërisht ai për prindërit, mendoj unë, është detyrim. Ndërsa ngritja e vlerave të tyre në artin poetik, është meritë dhe nder i atyre që e bëjnë këtë. Kjo, sepse, ata, përfaqësojnë cilësi e vlera që brezave të ardhshëm ju duhen. Për këtë arsye, poezia e Luigjit e ka kapërcyer personifikimin e të mbeturit thjeshtë ndjenja të djalit për babën e vet, por merr përmasat e një mendimi me vlera mbarë shoqërore. Prandaj thash se kjo nuk është vetëm një përjetim i veçuar i një individi, por merr vlerë të pazëvendësueshme dhe të paharrueshme.

qeveri. Shkurt të vësh dhe të lësh shpirtin e zemrën tek poezia, ashtu si Sergej Esenini i madh. Këto dy kërkesa të domosdoshme, sipas mendimit tim, krijimtaria poetike dhe jo vetëm poetike, e Luigj Shytit, i ka plotësuar në mënyrë mbresëlënëse. Në vlerësimin e kërkesave të mësipërme, i tërë vëllimi poetik "Lamtumirë mos thuj" është mbresëlënëse. Por si çdo gjë në këtë jetë ka nivelet, treguesit, lartësitë, dhe bukuritë e veta.

Në këtë rast e në këtë vëllim, unë, vlerësoj si mjaft të arrira nga ana artistike dhe emocionuese poezitë "Mirupafshim", "Më fal baba", "Sërisht do të vinë", "Na mungoni shumë", "Nënës time", "O bir", "Mall", "Ta kisha babanë", "Rikthim i lumturisë", e të tjera, që kur i lexon na kujtojnë jetën tonë, rrugët e jetës tonë me hallet e gëzimet, me ëndërrta e shpresat, me gjithçka na shfaqet zigzagia e jetës së secilit nga ne. Jo pak poezi të tjera si; "Për ty", "Çika e Dukagjinit", "Dashuri dhe liria", "Atje", "Shpresa", "Sa dua të jem zog", "Mëngjes", "Puthja", "Nëse", "Nuk e di", "Thinjat e mija", e plot të tjera janë poezi aq të bukura, aq të thjeshta, po aq domethënëse në mendime të koncentruar filozofik e popullor që lexon pak dhe kupton shumë. Dhe kur poezia ka këto cilësi, atëherë, vetëkuptohet se, bashkë me poezinë ka lindur edhe fati i bardhë i tyre për të qenë jetëgjata në mendjen e lexuesve. Disa nga këto poezi, të autorit Shyti, më ngjasojnë me atë stil të shkruarit

nga i papërsëritshmi Ferderik Reshpja.

Të vjen keq, madje shumë keq, se poet dhe poezi të tilla, gjithnjë e më radhë po shohim në dy dekadat e fundit. Prandaj i theksova, diku më lart, se këto poezi të Luigjit meritojnë vëmendje dhe vlerësim. Të flasësh me dhjetë rreshta për këtë libër, në realitetin e sotëm, mendoj unë, më tepër më ngjason me lënien në heshtje.

Filozofët e kanë konsideruar poezinë si shkallën më të lartë të ligjërit filozofik, prandaj është quajtur edhe si mbretëresha e fjalës së shkruar. Është quajtur kështu sepse poezia, si gjini e letërsisë artistike me të cilën mendimet, emocionet e ndjenjat shprehen në vargje, dhe se me këtë mendim filozofik të koncentruar, lexon pak dhe kupton shumë.. Duke pasur parasysh këtë mendim të koncentruar filozofik, kuptohet lehtë se poezitë e L. Shytit, i motivon dhe i aktualizon me argumente që kanë ekzistuar edhe më parë në shpirtin e njerëzve. Por të shprehura në vargje bëhen jetësore, kanë ide dhe synime, aspirata e mesazhe, prekin ndjenjat e njerëzve që gjejnë diçka nga jeta e vet brenda. Për këtë arsye, dhe shumë të tjera, mendimi poetik, pra poezia ka luajtur dhe luan rolin e vet pozitiv në forcimin e shoqërisë tonë, për vlerat që ajo mbart e përcjellë, jo vetëm për bashkëkohësit kur shkruhet poezia, por edhe për brezat e ardhshëm.

E them këtë se për zotin Shyti, për këtë intelektual fisnik, kontribuues, i palodhur

e i suksesshëm, si do që të shprehem nuk është e tepërt, kur do që të shprehemi nuk është vonë, në çdo mënyrë që ta vlerësosh sa më shumë, nuk ua lajmë borxhin që u kemi këtyre njerëzve të heshtur, të ditur dhe të dashuruar pas dëturisë e vendlindjes dhe çdo gjëje të mirë që ka jeta.

Ky malësor dukagjinasi, sa modest aq edhe i fuqishëm, i shkolluar dhe i formuar si arsimtar dhe qytetar, me tiparet më të mira bashkëkohore dhe dukagjinase, dhe të gjithë popullit tonë, tashmë e ka paraqitur të plotë portretin e vet, si intelektual atdhetar, të paktën në katër drejtime; si arsimtar shembullor dhe drejtues shkollë në rreth 75% të kohës së punës së tij në këtë sektor prej rreth 45 vjetësh, si studiues i suksesshëm, si publicist guximtar dhe realist dhe si një poet mbresëlënëse, Luigj Shyti, sapo e ka mbyllur punën në sektorin e arsimit, por jo atë të edukimit e të ndikimit pozitiv, jo atë të kontributit të vyer e shumë të rëndësishëm si studiues, atë të publicistikës e poezisë. Përvoja jetësore, përgatitja intelektuale, formimi i tij qytetar-atdhetar dhe angazhimi i tij i përditshëm, janë avantazhe dhe mundësi reale për të na dhënë, ne lexuesve, vepra të tjera dinjitoze, të cilat, ashtu si deri tani, do të jenë një ndihmesë e rëndësishme për historinë dhe vlerat e Dukagjinit, që me të drejtë e do aq shumë. Këto, pra krijimtaria e tij, do të jenë edhe një kontribut i vlefshëm në kulturën tonë kombëtare,

edhe për faktin e pamohueshme se, edhe Dukagjini me historinë e heronjtë, me qëndresën e progresin, me sakrificat për lirinë e përparimin e atdheut nga bijtë dhe bijat e tij trima dhe punëtorë, kanë zënë dhe do të zënë vendin e merituar në piedestalin e nderit të Dukagjinit e mbarë Kombit Shqiptar.

Për Luigj Shytin, për këtë kontribuues të edukuar, të heshtur, të pafjalë, dhe as mburrje, të pashpërblyer as më një qindarkë, fjalën e mirë ja kemi borxh. Është mirë që të flitet në kohë, sepse kur flitet pas kohë është gjysmë elozhe dhe gjysmë hipokrizi. Ata që e kursejnë fjalën e mirë për intelektual të tillë dhe krijimtarinë e tyre, harrojnë se një ditë do të shkojnë të gjithë "Atje", por Luigj Shyti do të kthehet prapë si "ujëvarë", do të kthehet si akordet e telave të shpirtit poetik të tij, "do të rrjedhin" për ne "...pa u ndalë", do të jenë të pavdekshëm...

"Për këto dua atje dhe të vdes,  
Se era e tokës do të më ngjallë,  
Kam me u kthye në ujëvarë,  
E për ju do rrjedhë pa ndalë.

Përfundon Luigj Shyti me këtë perlë poetike Naimjane.

**NDOC LOGU**  
Poet dhe publicist  
Korrik 2015

# LAMTUMIRË O MIK, O SHOK, O DUKAGJINAS I NDERUAR!

Me 28 shtator 2015 vdiq në Itali, pas një sëmundje të rëndë, ish punonjësi i dalluar i policisë, biri i shquar i fshatit Lekaj e i Dukagjinit Lulash Sokoli, në moshën 81 vjeçare.

Lulashi lindi në fshatin Lekaj në vitin 1934, në një familje me tradita të shquara patriotike, në një familje ku ishin tipare dalluese nderi, burrëria, bujaria e mikpritja, lindi në një familje ku u shfaq madhërisht urtësia e babës së tij Sokol Ndou, njeri me shpirtë e zemër të madhe, i mençuar e fisnik.

Në këtë truall lindi 81 vjet më parë Lulashi. Ai u rrit e u formua si njeri me vlera me cilësitë më të mira të cilat i demostroi në punë e në jetë kudo e kurdoherë, duke siguruar dashuri e respekt si bir i shquar i fshatit e i Dukagjinit, si një punonjës model i

Policisë Popullore për rreth 40 vjet në Dukagjin, në Malësinë e Madhe e së fundi në qytetin e Shkodrës.

Po përse do të rrojë gjatë kujtimi i tij në zemrat tona?

Lulashi, ky vigan me shpirtë e zemër të madhe, ishte i lindur e i formuar për të punuar me dashuri e pasion me njerëzit, duke fituar besimin e respektin e tyre, çka i ka garantuar kurdoherë suksesin e dëshiruar, për ti shpëtuar e larguar ata nga e keqja, nga veset, nga krimet e mundshme, nga shkelja e ligjit. Lulashi ishte mirënjohës, zotëruar i një vlere nga më njerëzoret. Ai ishte mirënjohës për prindërit, për familjen, për shokët, për miqtë, për gjithçka të mirë që i vinte prej tyre.

Lulashi karakterizohej nga thjeshtësia, nuk mburrej, deg-

jonte me vëmendje, nuk ngutej në përgjigjet apo në ndërhyrjet e tij. Edhe keqbërësin e trajtonte si njeri, pa të bërtitura, pa ofendime e banalitete, pa i cenuar krenarinë bashkëbiseduesit. Lulashi kishte një gjuhë të pastër, të qartë e të kuptueshme për bashkëbiseduesin. Për ate ishin të huaja ofendimet, banalitetet, çjerrjet.

Nga ana profesionale ishte bërë mjeshtër i punës, i zanatit, me një përvojë të gjatë, të cilën ua jepte edhe të tjerëve, shokëve më të rinjë.

Ai ishte model i punës, studimit, i të jetuarit me problemet e hallet e popullit, lexonte shumë, ishte mik i librit e i gazetarëve, në veçanti edhe i gazetës "Dukagjini", jo vetëm këtu, por edhe në emigracion. Gëzohej shumë për çdo arritje, për çdo vlerë

që buronte ose realizohej nga dukagjinasi në të gjithë sektorët e jetës, brenda dhe jashtë atdheut. Ashti siç gëzohej, edhe trishtohej për ngjarje, shfaqje e dukuri negative e sidomos për ndonjë tendencë baltosje të zonës nga njerëz të ndryshëm e sidomos nga disa "qytetar" dukagjinasi.

Vitet e fundit ai jetoi në emigracion, në Itali, aty ku punojnë e jetojnë djali dhe vajzat e tij, me nipat dhe mbesat që i donte aq shumë, por malli për Shkodrën, për malësinë, për vëllezërit e familjet e tyre, për shokët e miqtë e tij të shumtë nuk iu sos asnjëherë.

**Ndoc Grimaj**  
**Martin Cetina**  
**Prelë Shytani**  
**Mirash Uka**

## REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

**GJERGJ LEQEJZA**

**Ma.di.sh** **Kimay**  
PRODUCTION Produzione Giacche

